

RAPORTI I VLERËSIMIT TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE

EDICIONI I KATËRT



NËNTOR, 2015

Fotografia në faqen e pare: OSCE/Shehida Miftari, Mars 2015

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve
Botimi i katërt

Nëntor 2015

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
HYRJE.....	5
1. Dialogu ndërmjet komuniteteve.....	6
<i>Dialogu ndëretnik dhe ballafaqimi me të kaluarën</i>	6
<i>Arsimi dhe Dialogu</i>	8
2. SIGURIA DHE SISTEMI I DREJTËSISË	10
<i>Trendet në fushën e sigurisë dhe reagimet</i>	10
<i>Sundimi i ligjit.....</i>	13
<i>Të drejtat pronësore dhe zvogëlimi i ngarkesës së lëndëve</i>	15
<i>Qasja në drejtësi</i>	16
3. PËRDORIMI I GJUHËVE.....	18
<i>Zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve</i>	18
<i>Komisioneri për gjuhët dhe strukturat tjera të ngjashme.....</i>	20
4. ARSIMI.....	21
5. TË DREJTAT SOCIO-EKONOMIKE DHE PJESËMARRJA.....	24
<i>Të drejtat socio-ekonomike dhe qasja në shërbime</i>	29
<i>Komuniteti rom, komuniteti ashkali dhe komuniteti egjiptian i Kosovës.....</i>	31
6. INSTITUCIONET PËR TË DREJTAT E NJERIUT	34
7. KTHIMI DHE RIINTEGRIMI	37
8. KULTURA DHE MEDIAT.....	40
KONKLUZA DHE REKOMANDIME.....	44

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

KiK: Kuvendi i Kosovës

KK: Komiteti për komunitete

KKK: Këshilli Konsultativ për Komunitete

KE: Këshilli i Evropës

ZKKKK: Zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete

NKK: Nënkryetari i komunës për komunitete

PZH: Person i zhvendosur

KKPK: Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

KZM: Këshilli për Zbatim dhe Monitorim

AKP: Agjencia Kosovare e Pronës

PK: Policia e Kosovës

KPK: Këshilli Prokurorial i Kosovës

KGJK: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

MKK: Ministria për Komunitete dhe Kthim

KKSB: Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi

MKRS: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MASHT: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MAPL: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

ZKKK: Zyra komunale për komunitete dhe kthim

OJQ: Organizatë joqeveritare

ZÇK: Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit

ZQM: Zyra për Qeverisje të Mirë brenda Zyrës së Kryeministrit

IAP: Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë

ZKGJ: Zyra e Komisionerit për Gjuhët

ZK: Zyra e Kryeministrit

OSBE: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë

EPRBM: Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar

RTK: Radio-Televizioni i Kosovës

KOS: Kisha Ortodokse Serbe

ZVM: Zonë e veçantë e mbrojtur

UNHCR: Komisionari i Lartë i OKB-së për Refugjatë

UNMIK: Administrata e Përkohshme e Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i katërt për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misionit në Kosovë (OSBE), sikurse në raportet e mëhershme për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve ofron vlerësim të progresit të arritur nga institucionet e Kosovës në adresimin e rekomandimeve të Këshillit të Evropës (KE) për zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKPK).

Opinionin e tretë këshillues i KE-së, i publikuar së fundi më 6 mars 2013, thekson nevojën e institucioneve të Kosovës për t'i adresuar çështjet në fushën e dialogut ndërmjet komuniteteve, sigurisë dhe sistemit të drejtësisë, gjuhës, arsimit, të drejtat socio-ekonomike dhe pjesëmarrje, institucione për të drejtat e njeriut, kthim dhe riintegrim, si dhe kulturë dhe media. Opinioni këshillëdhënës gjen që, ndonëse është arritur progres i vazhdueshëm nga institucionet e Kosovës, përpjekjet kishin mungesë bashkërendimi dhe udhëzimi qendror dhe janë mbështetur në pjesë të madhe në përkrahjen ndërkombëtare. Raporti gjithashtu shpreh brengë për mungesën e ndërveprimit dhe dialogut ndërmjet komuniteteve, si dhe shprehjes së kufizuar të tolerancës në shoqëri me efekt negativ posaçërisht tek komunitetet më të vogla, të kthyerit dhe rininë.

Raporti i katërt i OSBE-së për vlerësimin e drejtave të komuniteteve vlerëson fushave që përbëjnë brengë dhe që janë theksuar nga opinionin e tretë këshillues dhe gjen që, përkundër disa hapave pozitivë, nevojiten më shumë përpjekje për avancimin e të drejtave të komuniteteve. Rekomandimet kyçe për institucionet e Kosovës përfshijnë nevojën për hapa të mëtejshme pozitivë për promovimin e dialogut dhe pajtimit, si dhe veprime për të adresuar pabarazinë e qasjes në drejtësi ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij joshqiptar dhe për adresimin më efektiv të incidenteve të sigurisë që prekin komunitetet, përfshirë këtu edhe përmes komunikimit të përmirësuar me komunitetin. Raporti thekson nevojën për të adresuar mosnjohjen e gjuhëve ashtu që të promovohet komunikimi ndërmjet komuniteteve, duke përfshirë këtu përmes transmetimit të përmirësuar mediatic shumëgjuhësh dhe, si shumë e rëndësishme, përmes sigurimit të kurrikulës së integruar arsimore që reflekton diversitetin etnik dhe gjuhësor në Kosovë. Zhvillimi i plotë konsultativ dhe zbatimi i legjislacionit për mbrojtje të trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve duket ketë prioritet. Gjithashtu, duhet të ngrihen kapacitetet dhe resurset e Institucionit të Avokatit të Popullit për të siguruar zbatim efektiv të përgjegjësive që ka ky institucion në trajtimin e diskriminimit. Për më tepër, një rekomandim kyç lidhet me nevojën për integrim më efektiv të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës në jetën sociale, ekonomike dhe politike, si dhe me krijimin dhe zbatimin e politikave të ndërlidhura dhe rishikimin dhe forcimin e mekanizmave përkatës bashkërendues. Nevojiten veprime të mëtejshme në përkrahje të zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur (PZH) nga Kosova të prekur nga konflikti, duke përfshirë këtu zgjidhjen dhe zbatimin e kërkesave të tyre pronësore.

HYRJE

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKPK) përfaqëson instrumentin ligjor më të rëndësishëm ndërkombëtar me të cilin matet llogaridhënia e institucioneve të Kosovës për të drejtat e komuniteteve.¹ KKPK përcakton parimet që duhet respektuar dhe synimet që duhet përmbushur nga institucionet për mbrojtjen e plotë të të drejtave të komuniteteve. Ajo zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë² dhe u siguron komuniteteve mbrojtje substanciale duke promovuar barazi në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore dhe duke krijuar kushte për t'ju mundësuar atyre shprehjen, ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës, fesë, gjuhës dhe traditave të tyre.

Legjislacioni në Kosovë gjithashtu garanton të drejtat e komuniteteve përmes, mes tjerash, Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Kosovë,³ Ligjit për përdorimin e gjuhëve⁴, ligjeve të arsimit⁵ dhe Ligjit për trashëgiminë kulturore.⁶ Si pjesë e mandatit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe ndërtimit të kapaciteteve të Kosovës për t'i përmbushur obligimet, OSBE rregullisht monitoron dhe raporton për hapat e ndërmarrë nga institucionet e Kosovës për t'i avancuar të drejtat e komuniteteve.

Raporti i katër i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve vlerëson progresin e shënuar nga institucionet e Kosovës në lidhje me rekomandimet e dhëna në serinë e fundit të rekomandimeve⁷ të KE-së, të miratuara më 26 nëntor 2014, dhe të siguruara me opinionin e tretë të komitetit këshillëdhënës (Opinionin i tretë i KE) për Kosovën.⁸ Ky raport pason raportet e mëhershme të OSBE-së për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve të publikuar në dhjetor 2009, dhjetor 2010 dhe korrik 2013 që përmbledhin progresin e arritur nga institucionet e Kosovës karshi rezolutave të mëparshme të miratuara nga KE.

Gjetjet e raportit bazohen në analizën e të dhënave sasiore dhe cilësore të grumbulluara nga OSBE në nivelin lokal dhe qendror gjatë periudhës raportuese 1 korrik 2014 deri më 30 qershor 2015. Përveç kësaj, janë përfshirë edhe një numër zhvillimesh të rëndësishme dhe me rëndësi të posaçme për Opinionin e Tretë dhe me interes të veçantë për OSBE-në, që kanë ndodhur para korrikut 2014 por pas publikimit të Raportit të fundit për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve⁹, të publikuar në korrik 2012. Informatat janë nxjerrë kryesisht nga instrumentet e përcjelljes së OSBE-së të krijuara për mbledhjen e të dhënave për çështje

¹ Sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, KKPK është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë dhe ka përparësi ndaj dispozitave ligjore vendore.

² Sipas nenit 22 të kushtetutës, KKPK është drejtpërdrejtë i zbatueshëm në Kosovë dhe ka përparësi mbi dispozitat ligjore vendore.

³ Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, 13 mars 2008.

⁴ Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, 27 korrik 2006.

⁵ Ligji nr. 04/L-032 për arsimin para-universitar, 31 gusht 2011; Ligji nr. 03/L-068 për arsimin në komuna të Kosovës, 15 qershor 2008.

⁶ Ligji nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore, 9 tetor 2006.

⁷ Rezoluta e CM/ResCMN(2014)13) për zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kosovë.

⁸ KE, Komiteti Këshillëdhënës për Konventën Kornizë për Pakica Kombëtare, *Opinion i tretë për Kosovë* ACFC/OP/III(2013)002, 6 mars, 2013:

http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_FCNMdocs/PDF_3rd_OP_Kosovo_en.pdf

⁹ OSBE, *Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve, Botimi i tretë* (korrik 2012)

<http://www.osce.org/kosovo/92244?doenload=true> (qasur më 28 tetor 2015).

specifike të analizuar në këtë raport, si dhe të publikuar së fundi në raportet e OSBE-së.¹⁰ Dimensioni gjinor është përfshirë në analizën në raste kur të dhënat kanë qenë në dispozicion.

Ashtu si në raportet e mëhershme për vlerësimin e të drejtave të komunitetit, ky raport paraqet risitë në progresin e Kosovës në trajtimin e të gjitha rekomandimeve nga Opinioni i tretë i KE-së në kuadër të një prej tetë fushave të gjëra tematike: Dialogu ndërmjet komuniteteve, Siguria dhe Drejtësia, Përdorimi i gjuhëve, Arsimi, Drejtat socio-ekonomike dhe Pjesëmarrja, Institucionet për të drejtat e njeriut, Kthimi dhe Riintegrimi, si dhe Kultura dhe Mediat. Për secilin rekomandim të vlerësuar, raporti shqyrton gjendjen aktuale dhe sfidat e mbetura që duhet adresuar nga institucionet e Kosovës. Raporti përfundon me rekomandime për të gjitha institucionet relevante me qëllim të përmirësimit të zbatimit të KKPK.

1. Dialogu ndërmjet komuniteteve

Rekomandimi 1

Të ndërmerren masa efektive për promovimin e mirëkuptimit dhe respektimit ndëretnik në të gjitha nivelet duke përfshirë këtu politikën transparente kulturore që bazohet në vlerësimin e diversitetit dhe themelimin e një sistemi arsimor të integruar dhe shumëgjuhësh. Të krijohen platforma adekuate ku anëtarë të grupeve të ndryshme, në veçanti rinia, do të mund të takoheshin dhe të bashkëvepronin.

Gjendja aktuale

Dialogu ndëretnik dhe ballafaqimi me të kaluarën

Të dhënat e fundit nga anketimi¹¹ tregojnë që vazhdon të ketë ndarje ndërmjet komuniteteve, ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës në veçanti. Dy vitet e fundit, domethënëse për nga progresi i dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës/Priştina i lehtësuar nga Bashkimi Evropian (Dialogu i Brukselit), kanë treguar një klimë më pozitive për promovimin e tolerancës dhe diversitetit ndërmjet komuniteteve, dhe ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Integrimi i katër komunave veriore të Kosovës me shumicë serbe në strukturat institucionale të Kosovës dhe pjesëmarrja shoqëruese e shtuar e serbëve të Kosovës në këto institucione janë tregues të rëndësishëm të progresit në marrëdhëniet ndëretnike. Përkundër klimës së përmirësuar dhe zotimit ligjor për “promovim të frymës paqësore, të tolerancës, dialogu ndërkulturor dhe ndërftetar, si dhe mbështetjes së pajtimit ndërmjet komuniteteve”¹², përpjekjet institucionale për të promovuar tolerancë dhe diversitet ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë kryesisht varen nga donatorët.

Në nivel qendror, arritja më e madhe deri më sot është themelimi i grupit të punës për ballafaqimin me të kaluarën dhe për pajtim, të kryesuar nga Zyra e Kryeministrit dhe me anëtarë nga një numër ministrish dhe organizatash të shoqërisë civile. Ndonëse është

¹⁰ Për shembull, raporti i OSBE-së, *Transporti i posaçëm për komunitetet në Dokumentin e politikave*, 4 mars, 2015 <http://www.osce.org/kosovo/143476> (qasur më 28 tetor 2015).

¹¹ ‘Distanca etnike në Kosovë’, publikuar në ‘Perspektivat e një shoqërie shumetnike në Kosovë’, f. 261, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Kosovë, maj 2015.

¹² Neni 3, *shënimi* 3 më sipër.

themeluar zyrtarisht në qershor 2012, grupi punues nuk është takuar rregullisht dhe ka bërë progres minimal në zhvillimin e Strategjisë për Drejtësinë Tranzicionale,¹³ si dhe ka pasur probleme në kuptim të përfaqësimit shumë të kufizuar të komuniteteve (pjesëmarrja e serbëve të Kosovës është kufizuar zakonisht me një pjesëmarrës). Që nga 30 qershori 2015 grupi punues nuk ka arritur të pajtohet për periudhën kohore që duhet të mbulojë strategjia, përkundër përkrahjes të konsiderueshme dhe inkurajimit të siguruar nga projekti i Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), enkas i menduar për përkrahje të grupit punues.¹⁴

Në nivel komunal, ka pasur shumë pak përpjekje sistematike për t'i afruar komunitetet. Ndërveprimi i përkrahur zyrtarisht ka tendencë të jetë i kufizuar në pjesëmarrje të përfaqësuesve të komuniteteve me funksione specifike në organet komunale, me mandate relevante për mbrojtje të komuniteteve në nivel lokal, siç janë, komitetet e komuniteteve (KK) që funksionojnë si pjesë e kuvendeve komunale. Në përgjithësi, pavarësisht nga progresi i arritur i regjistruar nga monitorimi i OSBE-së në terren, nënkryetarët për komunitete (NKK) dhe zëvendëkryesuesit e kuvendeve komunale për komunitete (ZKKKK) ende nuk i përgjigjen plotësisht rolit dhe mandatit të tyre për të promovuar dialog ndëretnik përmes angazhimit të kufizuar.¹⁵

Tensionet ndërmjet komuniteteve lidhur me kthimin e personave të zhvendosur (PZH) vazhdojnë të përsëriten. Komunitetet pritëse në lokacione të ndryshme vazhdojnë të shprehin kundërshtimin ndaj kthimit ose riintegrit të PZH-ve, si dhe ndaj pelegrinazhit fetar të PZH-ve dhe vizitave në varreza në disa komuna.¹⁶ Monitorimi i kryer nga OSBE tregon në shumicën e rasteve përpjekje të kufizuara komunale për adresimin e këtyre tensioneve dhe ndërtimin e mirëbesimit. Në përpjekje të kësaj natyre përfshihet bashkëpunimi politik i kryetarëve të komunës së Mitrovicës së veriut dhe Mitrovicës së jugut me qëllim të adresimit të tensioneve të Brdjani/Kroi i Vitakut, vend ky i kontestuar i kthimit me kompozicion të përzier etnik, që gjendet në zonën e kufirit administrativ të këtyre dy komunave. Kjo solli themelimin e grupit punues në qershor 2015, një nga tre sosh të themeluar në Kosovë me përkrahje nga niveli qendror, me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve në vendet ku kthimi është i vështirë.¹⁷

¹³ Gjatë periudhës raportuese, grupi punues për ballafaqimin me të kaluarën dhe pajtim u rigjallërua (qershor 2014) dhe formoi katër nëngrupe për të përkrahur hartimin e strategjisë për: të drejtën për të ditur; të drejtën për drejtësi; të drejtën për riatdhesim; dhe garancitë për mos-përsëritje. Përkundër zotimit për mbajtje të takimeve të përmuajshme, Grupi i punës u takua vetëm dy herë në 2014 dhe dy herë deri në qershor 2015, ndonëse nëngrupet janë takuar më rregullisht.

¹⁴ Për më shumë informata, ju lutem shihni:

http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/operations/projects/democratic_governance/support-to-transitional-justice-in-kosovo.html.

¹⁵ Neni 55.1, Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, 20 shkurt 2008, për ZKKKK, dhe 'nënkryetarët e komunave për komunitete – Termat e Referencës', miratuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) më 21 nëntor 2014.

¹⁶ Reagim ndaj kthimit dhe pelegrinazhit nga serbë të Kosovës është raportuar në: Mushtishtë/Mušutište (Komunë të Suharekës/Suva Reka), Korishë/Koriša (Prizren), dhe Shtupel/Štupelj (Klinë/Klina), Nerodime e Epërme/Gornje Nerodimlje (Ferizaj/Uroševac), dhe Lipjan/Lipljan. Reagim ndaj kthimit të PZH-ve romë, ashkali dhe egjiptianë nga Kosova është vërejtur në vendbanimin Ali Ibra (Komunë të Gjakovës/Djakovica), dhe për integrimin e tyre në Leposavić/Leposaviq.

¹⁷ Grupi punues ndërministrorë për kthim përbëhet nga përfaqësues nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria për Zhvillim Ekonomik, Ministria për Planifikim Hapësinor, dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Grupi punues ndërministror për kthim do të merr vendime që do të zbatohen nga të

Megjithatë, përmes monitorimit të saj, OSBE-ja ka identifikuar disa nisma të realizuara nga kryetarët e komunave. Në maj 2015, me mbështetje të OSBE-së, kryetarët e komunave të Štrpce/Shtrëpcës, Ferizajt/Uroševac dhe Klokot/Kllokotit nënshkruan një deklaratë të përbashkët për të promovuar dialogun ndëretnik dhe kanë caktuar zyrtarë për bashkëpunim në zbatimin e aktiviteteve në vitin 2015 dhe 2016 me financim komunal. Kjo deklaratë për bashkëpunim mes këtyre tri komunave erdhi si vijim i nismës së parë, marrëveshjes dhe deklaratës së vitit 2013 mes komunave të Gjilanit/Gnjilane, Kamenicës/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdës dhe Ranilug/Ranillugut, të cilat mbështetën disa aktivitete jo shumë të mëdha që për synim kishin rininë. Një shembull tjetër pozitiv, ndonëse përsëri pas mbështetjes ndërkombëtare, ishte Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar mes komunës së Suharekës/Suva Reka dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim për zbatimin e një projekti të kthimit dhe aktiviteteve që ndërlidhen me dialog¹⁸ në fshatin Mushtishtë/Mušutište.

Mediat e Kosovës janë ende me polarizime etnike, me raportim shpeshherë të anshëm dhe jo të plotë, si dhe të bazuar në shfrytëzimin e burimeve të gazetarëve që janë të kufizuar vetëm tek komunitetet e tyre. Problemeve të kësaj natyre iu shtohet edhe barriera gjuhësore që përbën pengesë të konsiderueshme në përmirësimin e perceptimeve dhe marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve, çështje kjo e lidhur me faktin që mediat shpeshherë nuk angazhojnë punonjës nga komunitete të ndryshme.

Arsimi dhe Dialogu

Nuk është arritur progres në adresimin e çështjes së ekzistimit të dy sistemeve të ndara të arsimit që në mënyrë të pashmangshme ndikon në ndarjen e mëtejshme të komuniteteve. Përkundër rekomandimeve të 'Komisionit të pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore gjuhësore në gjuhën serbe' të publikuara në vitin 2010 për rëndësinë e një sistemi unik arsimor për të gjitha komunitetet në Kosovë¹⁹ nuk janë ndërmarrë përpjekje serioze për trajtimin e ofrimit të veçantë të mësimin në gjuhën serbe, kryesisht për shkak të rrethanave të përgjithshme politike. Ndonëse Plani Strategjik i Arsimit 2011-2016 parasheh hartimin e kurrikulës për arsim në gjuhën serbe bashkë me librat shkollorë²⁰, nuk është shënuar progres në këtë çështje. Nxënësit serbë të Kosovës vazhdojnë të mësojnë vetëm në gjuhën serbe nëpër shkolla që menaxhohen nga institucionet e sistemit të Serbisë dhe nxënësit shqiptarë të Kosovës mësojnë vetëm në gjuhën shqipe në shkolla të menaxhuara nga sistemi i Kosovës, duke i kontribuuar kështu edhe më shumë barrierave gjuhësore në rritje. Për më tepër, nuk ka mundësi qoftë për nxënësit shqiptarë të Kosovës, qoftë për ata serbë të Kosovës t'i mësojnë gjuhët e komuniteteve numerikisht më të vogla. Shkollat që veprojnë dhe operojnë sipas sistemit të Kosovës me mësim në gjuhën turke dhe boshnjake u ofrojnë nxënësve të tyre

gjithë pjesëmarrësit. Grupi punues ndërministror për kthim miratoi themelimin e grupeve të punës në Brdjani/Kroi i Vitakut, fshatin Svinjare/Frashër në Mitrovicë/Mitrovica e Jugut, dhe në Mushtishtë/Mušutište në Suharekë/Suva Reka (Për më shumë informata, ju lutem kërkonit Rekomandimin 8 nga pjesa kryesore e këtij raporti).

¹⁸ Projekti zhvillohet brenda kontekstit të Fazës IV të BE-së për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë në partneritet me MKK.

¹⁹ Komisioni i pavarur i MASHT për shqyrtimin e materialeve mësimore në serbisht, f. 15, në:

[http://www.erisee.org/sites/default/files/-](http://www.erisee.org/sites/default/files/)

[%20Comprehensive%20Report%20of%20Independent%20Commission%20for%20the%20review%20of%20Serbian%20language%20teaching%20materials.pdf](http://www.erisee.org/sites/default/files/-) (qasur më 28 tetor 2015).

²⁰ Plani Strategjik për Arsim në Kosovë 2011–2016, faqe 76.

gjuhën shqipe si një prej gjuhëve zyrtare, por vetëm si lëndë e përzgjedhur e limituar në dy orë për javë.

Përgjithësisht, reforma e vazhdueshme arsimore në Kosovë ende nuk i ka adresuar këto nevoja të përbashkëta për mësim të gjuhëve, arsimim dhe integrim. Megjithatë, Ministria e Kosovës për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASHT) është zotuar për integrimin e të dhënave në Sistemin Informativ për Menaxhim të Arsimit të nxënësve serbë të Kosovës, mësimdhënësve dhe shkollave në vitin 2016.²¹ Pavarësisht kësaj, bashkëpunimi formal ndërmjet dy sistemeve arsimore pothuajse nuk ekziston, me përjashtim të disa rasteve kur hapësirat ose objekti shkollor është i përbashkët dhe ku janë bërë aranzhime edhe për ndarjen e kostos për mirëmbajtje dhe shërbime komunale.²² Megjithatë, nxënësit në shkolla të tilla të ‘përbashkëta’, zakonisht ndjekin apo zhvillojnë mësimin në ndërrime të ndryshme ose objekte të ndara brenda hapësirave shkollore dhe nuk organizohen kurrfarë aktivitete formale për ndërveprimin e nxënësve.²³

Mundësitë për ndërveprim ndërmjet nxënësve që ndjekin mësimet në dy sistemet e ndara arsimore kufizohen në iniciativa të shpërndara dhe të rralla të ndërmarrë nga organizatat ndërkombëtare apo organizatat joqeveritare (OJQ). Ndërveprimi ndërmjet nxënësve nga komunitete të ndryshme madje edhe brenda vetë sistemit të njëjtë arsimor është i gjithashtu i kufizuar dhe ndonëse ngjarjet e përgjithshme kulturore dhe sportive organizohen nga vetë shkollat, aktivitetet me qëllim promovimin e dialogun dhe kontaktin ndëretnik organizohen kryesisht nga OJQ-të.²⁴

Ndërkohë që hartuesve të politikave arsimore ende u duhet të bëjnë dispozita të qarta për të promovuar dialogun ndëretnik dhe kontaktin ndërmjet komuniteteve, një zhvillim pozitiv është referenca në promovimin e diversitetit kulturor, etnik dhe gjuhësor në Strategjinë ndërministrare për qeverisje lokale 2016–2026. Strategjia parashikon plane komunale të veprimit për promovimin e diversitetit etnik dhe gjuhësor, duke përfshirë mësimin në gjuhë lokale, aktivitete kurrikulare për multikulturalizëm dhe të drejta të njeriut, si dhe aktivitete të përbashkëta ekstrakurikulare për t’i bërë së bashku nxënësit nga komunitete të ndryshme.

Sfidat e mbetura

Promovimi i marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve mbetet sporadik në rastin më të mirë dhe institucionet kanë dështuar në adresimin e këtij problemi në çfarëdolloj mënyre sistematike. Përgjithësisht, marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve shpesh ndikohen nga mbulime të dobëta dhe të anshme mediatike, si dhe promovimi i tolerancës në mes të kthyerve potencialë dhe komuniteteve pritëse mbetet veçanërisht problematik. Ndonëse politikat arsimore ofrojnë mundësi të rëndësishme për promovimin e tolerancës ndëretnike dhe ndërtim të marrëdhënieve, ky sektor mbetet i ndarë dhe problematik në Kosovë: politika të ardhshme që

²¹ MASHT, *Aid[e] Memoire* i Shqyrtimit të Përbashkët Vjetor (SHPV) për 2014 në sektorin arsimor (pa datë), që është ndarë me OSBE në prill 2015.

²² Monitorimi i kryer nga OSBE-ja ka identifikuar 14 shkolla në 9 komuna (Gjilan/Gnjilane, Novoberdë/Novo Brdo, Klokot/Kllokot; Kamenicë/Kamenica; Viti/Vitina; Fushë Kosovë/Kosovo Polje; Lipjan/Lipljan; Obiliq/Obilić; Dragash/Dragaš).

²³ Monitorimi i OSBE-së ka theksuar raportime që nxënësit bashkëvepronin jo formalisht jashtë orarit të mësimin në tre nga nëntë komunat me shkolla të përziera, gjegjësisht : Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan dhe Dragash/Dragaš.

²⁴ Për shembull, “Balkan Sunflowers”, “Voice of Roma, Ashkali and Egyptians”, “PL4Y International”.

theksojnë shumë gjuhësinë dhe kontaktimin e rregullt dhe pozitiv, si dhe respektimin e të drejtave të njeriut të komuniteteve janë jetike.

2. SIGURIA DHE SISTEMI I DREJTËSISË

Rekomandimi 2

Të dënohen pa mëdyshje, menjëherë dhe në mënyrë sistematike në nivel qendror dhe lokal të gjitha aktet e armiqësisë ndëretnike. Të sigurohet që hetimet e policisë në incidentet e sigurisë që prekin komunitetet janë të shpejta dhe të pasuara me profesionalizëm nga shërbimet prokuroriale dhe gjyqësore për të promovuar besim në sundimin e ligjit, me masa të vendosura në të gjitha nivelet për t'i siguruar e bindur personat e zhvendosur dhe të kthyerit që kthimi i tyre është i mirëpritur.

Gjendja aktuale

Trendet në fushën e sigurisë dhe reagimet

Gjatë periudhës raportuese, OSBE ka regjistruar gjithsej 479 incidente në Kosovë, me potencial për të ndikuar negativisht në perceptimin e sigurisë të komuniteteve në pakicë numerike në nivel komunal.²⁵ Këto incidente ndryshonin nga vjedhja, sulm verbal, si dhe dëm i rëndë dhe uzurpim i paligjshëm i pronës (duke përfshirë vendet e trashëgimisë kulturore dhe varrezat), e deri tek incidentet që nxisin urrejtje dhe nacionalizim agresiv²⁶ dhe sulme fizike apo frikësime (edhe ndaj pelegrinëve fetar). Më shumë se gjysma e incidenteve të regjistruara (310) e kanë prekur komunitetin serb të Kosovës, duke përfshirë të kthyerit (të prekur në 22 për qind të 479 rasteve të regjistruara) dhe Kishën Ortodokse Serbe. Përderisa gjatë periudhës raportuese prej 1 korrik 2014 deri 30 qershor 2015 është shënuar rënie në numrin e incidenteve që prekin komunitetet në krahasim me 12 muajt e mëparshëm,²⁷ trendet kanë mbetur të ngjashme proporcionalisht, ku serbët e Kosovës përbënin pjesën më të madhe të ankuesve dhe të viktimave të supozuara.²⁸ Gjatë periudhës raportuese janë parë edhe dy “rritje të menjëhershme” në të dhënat e regjistruara: njëra në tetor 2014, kur një numër incidentesh janë nxitur nga ndeshja kualifikuese për Kampionatin Evropian 2016 ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë në Beograd²⁹; dhe e dyta në muajin maj dhe qershor 2015, kur është shënuar rritje e dukshme e incidenteve që kanë prekur të kthyerit në komunën e Klinës/Klina dhe Pejës/Peć, duke përfshirë gjuajtjen me gurë ndaj pronave dhe vjedhje.

Përgjithësisht, tensionet ndërmjet komuniteteve pritëse dhe të të kthyerve kanë vazhduar në disa vende ku kthimi është i vështirë që nga publikimi i Raportit të fundit të vlerësimit të të drejtave të komuniteteve, ku komunitetet pritëse kanë shprehur kundërshtimin e tyre të

²⁵ Incidentet vlerësohen duke u bazuar në disa faktorë, duke përfshirë edhe kontekstin, dhe në shumicën e rasteve kryerësi i supozuar dhe viktimat/ankuesit ishin nga grupe të ndryshme etnike.

²⁶ Incidentet ku përfshihej edhe vizatimi i grafiteve me mesazhe nacionaliste dhe të urrejtjes, sulmet verbale, ose djegia e flamurit të Serbisë në vende publike është vërejtur nga OSBE.

²⁷ 556 incidente janë shënuar në periudhën e mëhershme prej 1 korrik 2013 deri 30 qershor 2014.

²⁸ Në vitin para periudhës raportuese, 297 nga totali prej 556 incidentesh, të regjistruar nga OSBE, kanë prekur komunitetin serb të Kosovës.

²⁹ Ndeshja ishte ndërprerë pas fluturimit dhe uljes në fushë të një fluturakeje të vogël (droni) që mbante flamurin e ‘Shqipërisë së madhe’ dhe pamjet e dy figurave historike, duke shkaktuar përplasje ndërmjet lojtarëve të të dy ekipeve, duke u përhapur edhe tek shikuesit: një numër i caktuar i incidenteve ‘të bartura’ janë vërejtur në Kosovë gjatë periudhës pasuese.

fuqishëm ndaj kthimit të PZH-ve në disa lokacione.³⁰ Në këto raste përfshihen edhe kundërshtimet ndaj vizitave shko-dhe-shih ose shko-dhe-informo,³¹ dhe ankesat aktive kundër kthimeve dhe brengat e ndërlidhura të sigurisë në gjashtë komuna³². Në shumicën e vendeve ku kthimi është i vështirë, komunat nuk kanë ndërmarrë veprime për të ndërmjetësuar me komunitetin pritës në përkrahje të procesit të kthimit.

Përkritazi me sigurinë e komuniteteve të tjera që janë pakicë numerike në nivel komunal, është parë progres për komunitetin shqiptar të Kosovës në zona të largëta³³ të katër komunave veriore si dhe lehtësim në udhëtimin e tyre në pjesën jugore. Bllokimi i rrugëve/barrikadat e vendosura në veri gjatë gjithë vitit 2012 janë larguar, me përjashtim të një rasti³⁴, gjegjësisht urës kryesore që lidh Mitrovicën e jugut me atë të veriut, ku pengesat e improvizuara me vazo lulesh prej betoni (i ashtuquajtur 'park i paqes') në pjesën veriore të urës ende kufizojnë kalimin e veturave. Vlen të theksohet ceremonia për rivarrimin e figurës historike të shqiptarëve të Kosovës, Isa Boletini, në komunën e Zvečan/Zveqanit, ngjarje kjo e shtyrë më parë si pasojë e shqetësimeve të sigurisë, u mbajt në qershor 2015 pa probleme të sigurisë. Faktor kyç për lejimin e mbajtjen e rivarrimit ishte ndarja e komemoracionit masive të shqiptarëve të Kosovës, i cili u mbajt në Mitrovicë të jugut, dhe ceremonisë shumë më të vogël të rivarrimit në fshatin Boletin/Boljetin në Zvečan/Zveçan. Ngjarjet e ndara shmangën mundësinë e incidenteve ndëretnike që mund të kishin rezultuar nga prania e madhe e shqiptarëve të Kosovës në një komunë që përndryshe ka shumicë të serbëve të Kosovës.

Përgjithësisht, reagimet institucionale lokale ndaj sigurisë janë përmirësuar gjatë periudhës raportuese, por ka pasur edhe dënime publike nga disa komuna³⁵, kryesisht nga kryetarët e komunave, të incidenteve me peshë që kanë prekur perceptimin e komuniteteve për sigurinë. Për sa i përket funksionimit të mekanizmave lokalë që kanë mandat për të promovuar sigurinë, deri në fund të periudhës raportuese këshillat komunalë për siguri në bashkësi (KKSB-të)³⁶ janë themeluar në 34 nga 38 komunat e Kosovës.³⁷ Nga monitorimi i saj, OSBE-ja ka identifikuar përmirësime në funksionimin dhe performancën e KKSB-ve në krahasim me periudhën 2013-2014, duke përfshirë edhe mbajtjen më të shpeshtë të takimeve dhe fokusin e shtuar ndaj problemeve të sigurisë të komuniteteve në pakicë numerike në nivel

³⁰ Shih Raporti i OSBE-së *Vlerësimi i procesit të kthimit vullnetar* (tetor 2014), që identifikon disa vende ku kthimi është i vështirë dhe vë në pah kundërshtimin ndaj kthimit, fq. 18–19: <http://www.osce.org/kosovo/129321> (qasur më 28 tetor 2015).

³¹ Gjatë periudhës raportuese, OSBE ka vërejtur kundërshtime të tilla në: Mushtishtë/Mušutište (Komuna e Suharekës/Suva Reka), Nerodime e Epërme/Gornje Nerodimlje (Komuna e Ferizajt/Uroševac), dhe Brdjani/Kroi Vitakut (Komuna e Mitrovicës së veriut).

³² Gjatë periudhës raportuese, OSBE ka vërejtur peticione në Istog/Istok, Istog/Istok (Muzhevinë/Muzevine), Gjakovë/Đakovica, Pejë/Peć, Obiliq/Obilić (Plementinë/Plementina), dhe Klinë/Klina (Dresnik).

³³ Kjo ka prekur kryesisht komunitetin shqiptar të Kosovës në Zvečan/Zveçan dhe Leposavić/Leposaviq që kanë udhëtuar për në jug.

³⁴ Edhe hyrja lindore në Mitrovicë të veriut është pjesërisht e bllokuar me një pengesë të vjetër të ngritur, e që zakonisht shmanget nga automjetet duke e shfrytëzuar trotuarin.

³⁵ Gjegjësisht, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Mitrovicë e jugut, Gjakova/Đakovica, dhe Rahovec/Orahovac. Kryetarët e komunave të tjera të Kosovës me shumicë serbe si Gračanica/Gračanica, Ranilug/Ranillugu, Mitrovicë e veriut, Novo Brdo/Novobërda, dhe Parteš/Parteshi gjithashtu kanë dënuar publikisht incidentet që kanë prekur serbët e Kosovës si viktima të supozuara.

³⁶ Siç kërkohet me Udhëzim Administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Lokalë për Siguri Publike, 22 gusht 2012.

³⁷ Deri më 30 qershor 2015 nuk ka pasur KKSB të themeluara në katër komunat në veri të Kosovës (Mitrovicë Veriore, Zvečan/Zveçan, Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok), meqë këto komuna janë ende në proces të tranzicionit në strukturat administrative të Kosovës, pas progresit të arritur në dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës/Priština.

komunal, përfshirë këtu të kthyerit.³⁸ Në një të tretën e KKSB-ve (11)³⁹ nuk janë përfshirë përfaqësuesit e komuniteteve me prani të konsiderueshme në komunë, dhe pesë KKSB⁴⁰ nuk kishin përfshirë përfaqësues relevantë fetarë deri në fund të vitit 2015. Monitorimi i kryer nga OSBE-ja gjithashtu ka vërejtur se komuniteti rom, komuniteti ashkali dhe ai egjiptian, të gjithë të Kosovës, shpeshherë janë trajtuar si një komunitet i vetëm ‘RAE’ dhe me përfaqësim të vetëm një përfaqësuesi për të tri komunitetet si anëtar në KKSB. Shtatëmbëdhjetë KKSB⁴¹ nuk i paguajnë anëtarët e komuniteteve dhe kjo rezultoi me dekurajim për pjesëmarrje dhe angazhim joadekuat në çështjet e sigurisë që prekin komunitetet e tyre. Këshillat Lokalë për Siguri Publike (KLSP-të)⁴² janë mekanizëm shtesë në dispozicion të komuniteteve dhe shpesh këto këshilla i referojnë shqetësimet tek KKSB-të. KKSB-të në Gjilan/Gnjilane, Parteš/Partesh, dhe Klinë/Klina kanë vendosur praktikë pozitive të thirrjes së takimeve të jashtëzakonshme dhe dënimeve publike në reagim të incidenteve specifike, që është dëshmuar efektive në uljen e tensioneve dhe në theksimin e tyre tek kryetarët e komunave.

Në kuptim të reagimeve të institucioneve qendrore ndaj incidenteve, Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) ka publikuar mbi 30 dënime gjatë periudhës së raportimit dhe ka vizituar rajonet e prekura në disa raste. Një numër institucionesh tjera qendrore gjithashtu kanë lëshuar dënime, kryesisht në lidhje me incidentet relativisht më të rënda. Reagimet e Policisë së Kosovës (PK) ndaj shqetësimeve të komuniteteve për siguri kanë përfshirë monitorimin, ndërlihdjen e policisë me komunitetet dhe angazhimet për rekrutim. Për sa i përket monitorimit të nivelit qendror të incidenteve, PK ka zhvilluar një bazë elektronike të të dhënave për të regjistruar krimin, duke përfshirë këtu incidentet ndëretnike. Ndonëse baza e të dhënave bën edhe kategorizim sipas komuniteteve të viktimave të të gjitha llojeve të kimit, ajo ende nuk ofron mundësi për regjistrimin e rasteve si kategori e rastit e motivuar nga paragjykimi dhe, vetëm për disa raste, PK ka krijuar dhe përdorur dokumentacion në letër për t’i mbajtur dosjet me informata të motivimit si shtesë ndaj bazave elektronike të të dhënave. Kështu, policia nuk është në gjendje të nxjerrë statistika sistematike për krimet potencialisht të motivuara nga paragjykimi (‘krimet nga urrejtja), duke përfshirë incidentet e

³⁸ Gjatë 2014 e deri në qershor 2015, 15 KKSB kanë diskutuar tema relevante për komunitetet në pakicë numerike në komunat e tyre, dhe tre prej tyre kanë dënuar publikisht incidente të caktuara të sigurisë.

³⁹ Mospërputhje të rënda sa i përket anëtarësisë janë vërejtur në Gjakovë/Đakovica dhe Ferizaj/Uroševac, ku nuk ka përfaqësues të komunitetit rom, komunitetit ashkali, apo egjiptian. Për më tepër, duhet të caktohet anëtarë nga komuniteti ashkali edhe në Istog/Istok, Pejë/Peć, Obiliq/Obilić dhe Prizren. Gjithashtu, në Rahovec/Orahovac duhet caktuar një përfaqësues nga komuniteti rom i Kosovës, ndërsa në Prizren duhet caktuar një egjiptian dhe një serb të Kosovës. Përfaqësues të komunitetit turk të Kosovës duhet të caktohen në Fushë Kosova/Kosovo Polje a Dragash/Dragaš. Përfaqësues të boshnjakëve dhe goranëve të Kosovës duhet të bëhen anëtarë të KKSB-ve të Prishtinës/Priština dhe Gjilanit/Gnjilane.

⁴⁰ Komuniteti i protestantëve ende nuk është përfshirë në Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Vushtrri/Vučitrn dhe Prishtinë/Priština. KKSB në Malishevë/Mališevo duhet të përfshijë në përbërje përfaqësuesin e komunitetit katolik.

⁴¹ Klokoç/Kllokot, Novo Brdo/Novobërdë, Kaçanik/Kaçanik, Gjakovë/Đakovica, Lipjan/Lipjan, Prizren, Mitrovicë e jugut, Klinë/Klina, Prishtinë/Priština, Ferizaj/Uroševac, Parteš/Partesh, Ranilug/Ranillug, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Deçan/Deçane, Istog/Istok, dhe Graçanica/Graçanicë.

⁴² Këshillat lokalë për siguri publike janë themeluar në vitin 2006 me qëllim të “afritit të policisë me komunitete e ndryshme në Kosovë dhe për reagim më të mirë ndaj nevojave të tyre, rritjes së besimit dhe përfundimisht ofritit të sigurisë së shtuar për këto komunitete. Ato janë forume të veçanta për komunitetet dhe PK për të identifikuar dhe adresuar çështje të sigurisë të komunitetit në zonat e tyre dhe për t’ju dhënë atyre një zë në policimin lokal. Shih *Procedurat Standarde të Veprimit për Këshillat Lokalë për Siguri Publike*, Policia e UNMIK-ut, 2006.

motivuar nga përkatësia etnike.⁴³ Pa të dhëna të zërthyerë për incidentet me motivime etnike, aftësia e institucioneve të Kosovës për të krijuar politika për parandalimin e këtyre incidenteve do të mbesë e kufizuar. Ndonëse baza e të dhënave nuk mund të mbështetë regjistrimin dhe regjistrat e PK-së në vitin 2014 kanë regjistruar 19 incidente të ‘motivuar nga përkatësia etnike’ në krahasim me 20 sosh në vitin 2013.

Që nga RVDK i fundit, PK ka zhvilluar Strategjinë e saj të parë të Policimit në Bashkësi dhe Planin e Veprimit (2012-2016) me të cilat synohet përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet PK-së dhe komuniteteve. PK mban kontakt të rregullt me komunitetet përmes zyrtarëve policorë në bashkësi, dhe vazhdon të patullojë rregullisht dhe t’i vëzhgojë përmes pajisjeve të vëzhgimit lokacionet veçanërisht problematike. Në ato zona ku janë raportuar incidente të shumta të sigurisë ndaj komuniteteve joshqiptare janë vërejtur patrulla të shtuara të policisë, derisa në zonat që kanë qenë shënjestër e shpeshtë në komunën e Klinës/Klina, Pejës/Peç dhe Gračanica/Gračanicës janë vendosur videokamera vëzhgimi.

Për sa i përket përfaqësimit të komuniteteve joshqiptare në PK, që, siç është vërejtur në Opinionin Këshillëdhënës, është me rëndësi të rritet besimi i viktimave në hetime, që gjithashtu pritet të rrisë raportimin nga ana e komuniteteve, nga gjithsej 7,635 zyrtarë policorë sa numëron PK-ja 16 për qind u përkasin komuniteteve joshqiptare, më saktësisht 967 zyrtarë policorë serbë të Kosovës, 65 turq të Kosovës, 181 boshnjakë të Kosovës, 13 romë të Kosovës, 17 ashkali të Kosovës, 37 goranë të Kosovës dhe 9 egjiptianë të Kosovës⁴⁴. Këto statistika pasqyrojnë ndryshimet e bëra kohëve të fundit si rezultat i marrëveshjes së arritur në dialogun në Bruksel⁴⁵ për t’i përfshirë në strukturat e Kosovës 338 ish-zyrtarë policorë serbë, e që çoi në transferimin e 284 pjesëtarëve të ri në Drejtorinë Rajonale të PK-së të Mitrovica/Mitrovicës së Veriut.

Sundimi i ligjit

Në një sondazh publik⁴⁶ të realizuar nga OSBE në vitin 2014, 67 për qind e respondentëve joshqiptarë deklaruan se mosbesimi ndaj institucioneve gjyqësore të Kosovës përbënte pengesë serioze që ata t’i realizojnë të drejtat e tyre. 42 për qind (15 nga 35) të respondentëve joshqiptarë të cilët kishin pasur çështje për gjykatë gjatë dy vjetëve të fundit nuk kishin ndërmarrë asgjë për këto çështje, krahasuar me 19 për qind (37 nga 193) të respondentëve shqiptarë të Kosovës. Pabarazia në sistemin e drejtësisë kur çështjet shkojnë në gjykatë është përmendur si pengesë serioze nga 68 për qind e respondentëve joshqiptarë, dhe monitorimi i realizuar nga OSBE-ja ka identifikuar pabarazi të mëdha mes komunitetit shqiptar dhe atij joshqiptar të Kosovës për sa i përket qasjes në drejtësi. Për shembull, në 42 për qind (37 nga

⁴³ Në krimin e motivuar nga paragjykimi mund të përfshihet: religjioni, raca, etnia, orientimi seksual, gjuha, etj.

⁴⁴ Informatë nga Drejtori i PK për Administratë ndarë me OSBE-në në qershor 2015.

⁴⁵ Me lehtësimin e Bashkimit Evropian dhe siç parashihet në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/298 të vitit 2010, procesi me bazë në Bruksel i dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës/Priştina ka qenë vazhduar përmes takimeve periodike teknike dhe të nivelit të lartë që nga viti 2011. Synimi i përgjithshëm është normalizimi i marrëdhënieve, ku pikë arritjeje është Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve e inicializuar në prill 2013. Temat të tjera kanë qenë të lidhura me regjistrin civil, kadastrin, tregtinë, lirinë e lëvizjes, energjinë, telekomunikacionin, dhe të tjera.

⁴⁶ Sondazhi u realizua në nëntor të vitit 2014 nga kompania kërkimore Regional Enterprise Agency (Prishtina REA) dhe Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD), me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Sondazhi përfshiu gjithsej 1,300 respondentë, prej të cilëve 184 ishin joshqiptarë.

87 raste) të lëndëve të monitoruara nga OSBE-ja në vitin 2014 ku palët në procedurë ishin joshqiptare, asnjëra nga palët nuk kishte avokat, krahasuar me 32 për qind (218 nga 676) të lëndëve ku palë ishin vetëm shqiptarët e Kosovës.⁴⁷ Faktor i madh kontribuues duket të jetë mungesa e avokatëve joshqiptarë: vetëm 5 për qind e avokatëve të regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës i përkisnin komuniteteve joshqiptare.⁴⁸ Ngjashëm, mungesa e shërbimeve të përkthimit gjithashtu mund të jetë pengesë, në 61 për qind të rasteve të monitoruara nga OSBE-ja ku ishin të përfshirë joshqiptarë dhe kishte nevojë për përkthim, ose nuk ka pasur fare përkthim ose ka qenë i dobët.⁴⁹ Për më tepër, derisa gjuha serbe është gjuhë zyrtare në Kosovë, ajo rrallëherë përdoret si gjuhë e procedurës. Nga të 105 lëndët penale me të pandehur të vetëm serb të Kosovës që OSBE i ka monitoruar në vitin 2014, asnjëra çështje nuk është shqyrtuar në gjuhën serbe. Në fund, komunitetet në veriun e Kosovës, kryesisht serbët e Kosovës, janë të përjashtuar plotësisht nga institucionet e Kosovës, ngaqë sistemi i drejtësisë në Kosovë (me përjashtim të pjesës së udhëhequr nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë) nuk ka arritur ende të ushtrojë efektivisht kompetencën e vet në atë rajon.⁵⁰

Shumica dërmuese e respondentëve joshqiptarë të sondazhit të OSBE-së e kanë cilësuar neglizhencën dhe vonesën në trajtimin e rasteve nga institucionet përkatëse të drejtësisë si pengesë madhore në realizimin e të drejtave të tyre (87 nga 184 respondentë joshqiptarë dhe 843 nga 1116 respondentë shqiptarë)⁵¹. Monitorimi i OSBE-së shpalosë se në raste të caktuara me rëndësi të veçantë për pjesëtarët e komuniteteve joshqiptare, çështjet nuk trajtohen me efikasitet dhe efektshmëri maksimale. Për shembull, në janar të vitit 2015, OSBE-ja publikoi një raport për rastet e riuzurpimit të paligjshëm në Kosovë⁵² që vinte në dukje se rastet e tilla nuk po trajtoheshin nga gjyqësori dhe/ose prokuroria në mënyrën e duhur. Këto raste nuk ishin hetuar shpejt, ndjekur penalisht në mënyrën e duhur apo shqyrtuar nga gjykatat në kohë, dhe sanksionet e vendosura nuk ishin të mjaftueshme për të qenë mjet juridik apo shkrajues adekuat.⁵³ Ngjashëm, monitorimi i realizuar nga OSBE-ja ka shpalosur mangësi të mëdha në procedimin e krimeve të mundshme të urrejtjes. Këto raste rrallëherë shkojnë në gjykatë dhe shpesh ngelin diku mes policisë dhe prokurorisë, duke u cilësuar si vepra me "kryerës të panjohur", dhe as policia e as prokuroria nuk i çojnë deri në fund

⁴⁷ Shih *Monitoruesin e drejtësisë* e OSBE-së: *Qasja në drejtësi* në dispozicion në: <http://www.osce.org/kosovo/125242>.

⁴⁸ Moshë mesatare e këtyre avokatëve është 63 vjeç. Kështu, ka të ngjarë që problemi të përkeqësohet në vitet e ardhshme me daljen në pension të këtyre avokatëve, nëse nuk merren masa për rritjen e numrit të avokatëve nga komunitetet joshqiptare. Në qoftë se çohen me sukses deri në fund, atëherë përpjekjet e planifikuara nga Qeveria për të nxjerrë një udhëzim administrativ që u lejon të diplomuarve nga Universiteti i Mitrovicës/ Mitrovicës së Veriut t'i nënshtrohen provimit të jurisprudencës do të ishte një hap i madh në këtë drejtim.

⁴⁹ Shënimi i 46-të më sipër.

⁵⁰ Zhvillimet e fundit në kuadër të marrëveshjeve të arritura përmes Dialogut në Bruksel tregojnë se sistemi i drejtësisë i Kosovës do ta shtrijë juridiksionin edhe në pjesën veriore të Kosovës.

⁵¹ *Shënimi më sipër* 46.

⁵² Shih raportin e OSBE-së "Shqyrtim i rasteve të riuzurpimit të paligjshëm në Kosovë" (janar 2015), <http://www.osce.org/sq/kosovo/141136> (qasur më 28 tetor 2015). Rastet që OSBE i ka shqyrtuar në kuadër të këtij raporti ishin të lidhura me prona nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës, që merrej vetëm me pronat në jug të lumit Ibër/Ibar. Si të tilla, rastet përfshinin viktimë serbe të Kosovës dhe uzurpues shqiptar të Kosovës.

⁵³ Shih për shembull, Diagrami 6 Statusi i rasteve në Gjykatat Themelore, Diagrami 7 Muajt e duhur për zgjidhjen e rasteve nga gjykatat themelore kundrejt rasteve të pazgjidhura për një gjyqtar në Gjykatat Themelore, ose Diagrami 8 Dënimet që vendosen pas vendimeve të fajësisë, siç është paraqitur në raportin e OSBE-së 2015 *Shqyrtimi i rasteve të riuzurpimit të paligjshëm në Kosovë*, shënimi më sipër **Error!**

Bookmark not defined..

hetimet për t'i identifikuar kryerësit.⁵⁴ Për shembull, në vitin 2014, OSBE ka monitoruar 27 raste ku kishte arsye të forta për të besuar se përbënin vepra penale të urrejtjes. Deri më 30 qershor 2015, asnjëri rast nuk ishte dërguar ende në gjykatë, ndërsa kryerësit e mundshëm u identifikuan në vetëm tre raste, e 24 tjera duket të jenë endur sa andej këtej në PK dhe prokurori me kërkesa për më shumë informata në mënyrë që të mund të ecej përpara.

Sfidat e mbetura

Incidentet e sigurisë që ndikojnë në raportet dhe besimin e ndërsjellë në mes të komuniteteve, duke përfshirë këtu komunitetet e kthyera dhe ato pritëse, mbeten sfidë e vazhdueshme dhe e madhe. Institucionet e Kosovës ende nuk kanë krijuar dhe zbatuar praktika konsistente të dënimeve të incidenteve ndëretnike të sigurisë, duke siguruar që dënimet publike ta arrijnë popullsinë shumicë dhe komunitetet e prekura. Në nivel lokal, KKSB-të duhet t'i mbështesin në mënyrë më efektive komunitetet në aspektin e sigurisë dhe të sigurojnë përfaqësimin e duhur të të gjitha komuniteteve dhe besimeve fetare. Katër komunat veriore nuk i kanë themeluar KKSB ende, dhe duhet të sigurojnë pjesëmarrjen aktive të të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunën përkatëse. Institucionet nga të dyja anët e lumit duhet të gjejnë një zgjidhje afatgjatë e të pranueshme për sigurimin e lirisë së lëvizjes mbi urën kryesore mbi lumin Ibër/Ibar dhe t'i largojnë gjithë barrierat që pengojnë lirinë e lëvizjes. Analizat e hollësishme për përcjelljen e veprave penale të motivuara nga paragjykimi ose urrejtja nuk janë të mundura me bazën aktuale të të dhënave aktuale të krimeve në PK dhe progresi në rekrutimin e zyrtarëve policorë nga komunitetet joshqiptare ende nuk ka çuar në përfaqësim proporcional të komuniteteve më të vogla joshqiptare.

Rekomandimi 9

Të ndërmerren masa aktive për ta zvogëluar numrin e lëndëve të vjetra të grumbulluara, përfshirë këtu rastet pronësore, dhe të përmirësohet qasja e komuniteteve joshumicë në drejtësi përmes trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarët dhe dhënies prioritet punësimit të profesionistëve ligjorë nga radhët e komuniteteve joshumicë, si dhe t'i sigurohet gjithë mbështetja e nevojshme koordinatori kombëtar për të drejtat pronësore.

Situata e tanishme

Të drejtat pronësore dhe zvogëlimi i ngarkesës së lëndëve

Pas miratimit të Strategjisë së Kosovës për zvogëlimin e numrit të lëndëve të vjetra të grumbulluara të gushtit 2013, për herë të parë që nga viti 1999 është parë një rënie e lehtë në numrin të lëndëve të vjetra të grumbulluara nëpër gjykata themelore, nga 224,586 raste sa ishin në janar të vitit 2014 në 213,237 në janar të vitit 2015⁵⁵. Megjithatë, nuk ka pasur përparim në uljen e numrit të lëndëve të vjetra të grumbulluara në Gjykatën Supreme apo në Gjykatën e Apelit. Koordinatori për të drejtat pronësore, i cili u emërua në vitin 2011 për ta adresuar numrin e madh të rasteve pronësore të pazgjdhura, nuk pati sukses, dhe pozita ka mbetur e zbrazët që nga janari 2015. Deri më 2 qershor 2015, Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) i kishte shqyrtuar gati të gjitha kërkesat e mbetura pronësore që kishin rezultuar nga konflikti, gjithsej 42,749 raste. Megjithatë, afro 540 raste janë ende në procedurë të

⁵⁴ Ndryshimet në Kodin nr. 04/L-12 për procedurën penale të 1 janarit 2013, që i japin PK-së më shumë kompetenca për të hetuar pa ndërhyrjen e prokurorit duket të jenë një prej shkaqeve të këtyre problemeve, dhe kanë krijuar huti rreth asaj se kush e ka përgjegjësinë për të zhvilluar hetime në raste të caktuara.

⁵⁵ Për më shumë informata, shih: *Raport vjetor 2014* i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, f. 25 në <http://kgjk-ks.org/?cid=1,1>.

ankimimit pranë Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme të Kosovës.⁵⁶ Sidoqoftë, përparim i paktë është bërë lidhur me aftësinë e AKP-së, PK-së dhe të gjyqësorit për t'i zbatuar këto vendime dhe shumë prona u riuzurpuan shpejt në mënyrë të paligjshme. Nga riuzurpimet e paligjshme janë prekur më së shumti personat e zhvendosur të cilët kanë qasje të kufizuar në pronat e tyre, dhe atyre u duhet ta paguajnë tatimin në pronë të akumuluar⁵⁷ për pronat e uzurpuara në mënyrë të paligjshme që nuk i kanë në posedim.

Marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut të Brukselit sollën disa zhvillime të reja gjatë kësaj periudhe të raportimit, duke përfshirë këtu shkëmbimin e regjistrave kadastralë, që priten të kontribuojnë në mbrojtjen e të drejtave pronësore të të gjitha komuniteteve. Një projektligj për themelimin e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, detyrë kryesore e së cilës është paraparë të jetë krahasimi i të dhënave kadastrale në Prishtinë/Pristina dhe ato të Beogradit, iu dërgua Kuvendit të Kosovës (KK) në shkurt të vitit 2015.⁵⁸

Qasja në drejtësi

Siç u vu në dukje në Rekomandimin e 2-të më sipër, besimi i komuniteteve joshqiptare në sektorin e drejtësisë ka vazhduar të jetë i dobët gjatë tërë periudhës së raportimit. Mbyllja e zyrave për ndihmë juridike të financuara nga UNDP në Mitrovica/Mitrovicën e Veriut dhe Gračanica/Gračanicë në maj të vitit 2014 u përcoll me shqetësime të mëdha për sa i përket qasjes së komuniteteve joshqiptare në drejtësi në këto rajone, të cilëve u janë zvogëluar në masë të madhe opsionet për ndihmë juridike, posaçërisht në gjuhën serbe.⁵⁹ Është vërejtur ca përparim për sa i përket qasjes fizike të komuniteteve joshqiptare në drejtësi, me përirimin e një gjykate të re në komunën e Štrpce/Shtërpçës në shtator të vitit 2014 dhe emërimin e një gjyqtari të ri serb të Kosovës në maj të vitit 2015 në degën e Gjykatës Themelore të Prishtinës/Pristina në Gračanica/Gračanicë (për më se 9 muaj, kjo degë ishte pa gjyqtar në të shumtën e kohës)⁶⁰, si dhe shpalljen e konkursit edhe për dy gjyqtarë tjerë.⁶¹ Në komunën e Novo Brdo/Novobërdës, ku jeton një numër i konsiderueshëm i serbëve të Kosovës, dega e Gjykatës Themelore ka vetëm një gjyqtar shqiptar të Kosovës dhe vazhdon të jetë e vendosur në një shtëpi private në fshatin Llabjan/Labjane të banuar nga komuniteti shumicë shqiptar i Kosovës, për ku nuk ofrohet shërbim adekuat i transportit publik.⁶² Sipas Këshillit Gjyqësor

⁵⁶ Intervistë e OSBE-së me Ushtruesin e detyrës së drejtorit të Agjencisë Kosovare të Pronës, 2 qershor 2015.

⁵⁷ Neni 1.11, Ligji nr. 03/L –204 për tatimin në pronën e paluajtshme, 7 tetor 2010, parasheh që tatimpagues për tatimin në pronën e paluajtshme është pronari ose shfrytëzuesi i pronës.

⁵⁸ Projektligji u miratua nga institucione e Kosovës më 5 shkurt 2015 dhe iu procedua Kuvendit të Kosovës më 25 shkurt 2015.

⁵⁹ Këto dy zyra, së bashku me zyrat në gjashtë komuna tjera (Klokot/Kllokot, Ferizaj/Uroševac, Skenderaj/Srbica, Klinë/Klina, Gjakovë/Đakovica dhe Dragash/Dragaš), u hapën sërish përmes një projekti të Ambasadës Norvegjeze në janar të vitit 2015. Mirëpo, projekti zgjati për vetëm gjashtë muaj dhe zyrat u mbyllën sërish në qershor të vitit 2015.

⁶⁰ Një gjyqtar është emëruar përkohësisht në gjykatën e degës në Gračanica/ Gračanicë midis gushtit 2014 dhe fundit të janarit 2015, por ka trajtuar vetëm rastet civile. Nga janari e tutje nuk kishte asnjë gjyqtar deri në emërimin në maj 2015.

⁶¹ Shpallja e KGJK-së për pozita të lira të gjyqtarëve e marsit 2015, që u mbyll më 25 maj 2015 (vegza nuk është në dispozicion më).

⁶² Gjykata shqyrton vetëm lëndë penale, dhe këto raste i caktohen vetëm një prokurori nga Gjilani/Gnjilane, i cili e viziton gjykatën një herë në javë.

të Kosovës (KGJK), në Kosovë janë gjithsej pesë prokurorë joshqiptarë⁶³, por asnjëri nga ata nuk i përket komunitetit goran të Kosovës, rom të Kosovës, egjiptian të Kosovës, ashkali të Kosovës, malazez të Kosovës apo kroat të Kosovës.⁶⁴ KGJK-ja dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) morën masa për ta adresuar këtë gjendje në mars të vitit 2015, duke shpallur një konkurs për plotësimin e 48 vendeve të lira në gjyqësor dhe 15 vendeve të lira në prokurori me pjesëtarë të komuniteteve joshqiptare.⁶⁵

Në maj të vitit 2015, Kuvendi i Kosovës i miratoi ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për gjykatat⁶⁶, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës⁶⁷, Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës⁶⁸ dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit⁶⁹. Këto ndryshime dhe plotësime i adresonin dhe fuqizonin kriteret për trajnime, procedurat e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe përgjegjësitë e të dy këshillave, atij gjyqësor dhe prokurorial. Megjithëse neni 5 i Ligjit për gjykatat përcakton që përbërja e gjyqësorit duhet ta pasqyrojë shumëllojshmërinë etnike të Kosovës, si edhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial të secilës gjykatë⁷⁰, këto ligje nuk u referohen shprehimisht gjyqtarëve dhe prokurorëve, ose kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë nga radhët e komuniteteve joshqiptare.

Në rrafshin e politikave, Plani strategjik i KGJK 2014-2019 parasheh që gjyqësori t'i inkurajojë komunitetet joshqiptare për të qenë pjesë e sistemit gjyqësor, duke vënë theksin në shtimin e aktiviteteve të kontaktimit të komuniteteve joshumicë dhe ndërmarrjen e hapave për të siguruar që në gjykata të ketë përkthyes të shkathtë dhe adekuatë.⁷¹ Plani vjetor i KPK-së për vitin 2015⁷² renditë po ashtu përbërjen etnike të prokurorive si çështje që duhet adresohet dhe të shqyrtohet rregullisht. Gjatë periudhës së raportimit, Oda e Avokatëve të Kosovës numëronte vetëm 23 avokatë joshqiptarë⁷³, ose 5 për qind të anëtarësisë: Oda ka themeluar *Komitetin për komunitete joshumicë* me qëllim kryesor rritjen e numrit të avokatëve joshqiptarë. Asnjëra nga këto institucione nuk kanë raportuar në raportet e tyre përkatëse për vitin 2014 për veprime konkrete për adresimin e këtyre mangësive, gjë që flet për mungesë veprimesh. Programet e specializuara të trajnimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë nuk u përfshinë në planet vjetore të punës për vitet 2014 dhe 2015, dhe të njëjtit raporte nuk përmbajnë asnjë të dhënë rreth numrit të pjesëmarrësve joshqiptarë që ka vijuar këto trajnime gjatë vitit 2014 dhe 2015

⁶³ Dy serbë të Kosovës, dy boshnjakë të Kosovës, një turk i Kosovës.

⁶⁴ Sipas listës së prokurorëve që i është dhënë OSBE-së më 25 qershor 2015 (lista është përditësua më 1 qershor 2015). KGJK nuk posedon me të dhëna të përditësuara për numrin e prokurorëve të kategorizuar sipas përkatësisë etnike.

⁶⁵ Data e fundit për aplikim ishte 25 maj 2015, ndërsa intervistat me gjyqtarët dhe prokurorët serbë të Kosovës u zhvilluan në qershor dhe korrik. Deri në tetor të vitit 2015, kandidatët e suksesshëm ende nuk ishin të dekretuar nga Presidentja.

⁶⁶ Ligji nr. 05/L-032 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-199 për gjykatat, 30 qershor 2015.

⁶⁷ Ligji nr. 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, 30 qershor 2015.

⁶⁸ Ligji nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, 30 qershor 2015.

⁶⁹ Ligji nr. 05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-225 për Prokurorin e Shtetit, 30 qershor 2015.

⁷⁰ Ligji nr. 03/L-199 për gjykatat, 22 korrik 2010.

⁷¹ *Plani strategjik i gjyqësorit të Kosovës 2014–2019*, qëllimi strategjik 3.1.1: http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/plani_strategjik_2014_2019_alb_103718.pdf.

⁷² Plani vjetor i KPK-së për 2015: http://www.psh-ks.net/repository/docs/KPC_Annual_Action_Plan_2015.pdf

⁷³ Oda e Avokatëve të Kosovës, *Raport vjetor 2014*, f. 163.

(përqindja e pjesëmarrësve joshqiptarë në vitin 2013 ishte jashtëzakonisht e ulët me vetëm 0.7 për qind).⁷⁴

Sfidat e mbetura

Zvogëlimi i numrit të lëndëve të vjetra të grumbulluara, posaçërisht i atyre të Gjykatës Supreme, vazhdon të përbëjë sfidë. Deri në fund të qershorit 2015, nuk ishte bërë asnjë përparim sa i përket emërimit të koordinatorit për të drejtat pronësore, si dhe ndarjes së burimeve të duhura për këtë pozitë, ashtu që të mund të vihet në shërbim të përkrahjes së të drejtave pronësore të komuniteteve. Zbatimi i vendimeve të AKP-së është i dobët, ndërsa çështja e uzurpimit dhe riuzurpimit të paligjshëm mbetet sfidë serioze nga e cila preken sidomos PZH.⁷⁵ Përveç sfidave përballë PK-së dhe gjyqësorit në kuptim të zbatimit, krahasimi i regjistrave kadastralë që pritet të bëhet së shpejti do të përbëjë sfidë potenciale për të siguruar masa mbrojtëse adekuate për PZH-të, sidomos duke marrë parasysh mbarimin e mandatit të AKP-së.

Zbatimi i duhur i Ligjit për përdorimin e gjuhëve⁷⁶ ende çalon në procedura gjyqësore, procesin e përkthimit në çështjet gjyqësore, si dhe qëndrueshmërinë e ndihmës juridike falas që aktualisht varet nga donacionet. Plani strategjik 2014-2019 i KGJK-së dhe Plani vjetor i KPK-së përfshijnë një numër hapash të rëndësishëm për integrimin e komuniteteve në sistemin gjyqësor të Kosovës, por ato ende nuk janë zbatuar. Përfaqësimi i komuniteteve në sistemin gjyqësor, përfshirë këtu edhe avokatët dhe prokurorët, përbën shqetësim të veçantë, veçanërisht për komunitetet më të vogla numerikisht. Veç kësaj, ende nuk i është dhënë prioritet planifikimit dhe zbatimit të programeve të trajnimeve për gjyqësorin për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshqiptare.

1. PËRDORIMI I GJUHËVE

Rekomandimi 3

Të përmirësohet zbatimi i legjislacionit për gjuhët në nivel qendror dhe lokal. Komisioneri për gjuhët të mbështetet në ushtrimin e funksionit të tij përmes burimeve adekuate njerëzore dhe financiare, dhe t'i jepet prioritet krijimit të një mjedisi ku shumëgjuhësia në sferën publike inkurajohet aktivisht.

Situata e tanishme

Zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve

OSBE ka vërejtur disa zhvillime pozitive sa i përket zbatimit të legjislacionit të Kosovës për përdorimin e gjuhëve. Që nga dhjetori i vitit 2013, Ministria e Punëve të Brendshme ka filluar që me kërkesë të aplikuesit të lëshojë edhe letërnjoftime në gjuhën turke, ndërsa në korrik të vitit 2015 ka instaluar një softuer të ri që u mundëson komunave të lëshojnë formularë dhe shabllonë të gjendjes civile në gjuhën boshnjake dhe atë turke, si edhe me

⁷⁴ Instituti Gjyqësor i Kosovës, *Raport vjetor 2013*, f. 15: https://igjk.rks.gov.net/Uploads/Documents/RapVj2013_.pdf

⁷⁵ Për diskutime më të hollësishme të këtij problemi, ju lutem shihni raportin relevant të OSBE-së, *shënimi më sipër* **Error! Bookmark not defined.**

⁷⁶ Shënimi 4 më sipër.

alfabetin cirilik.⁷⁷ Megjithatë, monitorimi i realizuar nga OSBE-ja gjatë periudhës 1 shtator 2014 deri 31 mars 2015 ka theksuar një mungesë të vazhdueshme të progresit sa i përket respektimit të detyrimeve për përdorimin e gjuhëve nga ana e komunave, përfshirë ofrimin e shërbimeve dhe dokumenteve për publikun dhe përkthimin në të gjitha gjuhët zyrtare.⁷⁸ Komunitetet dhe përfaqësuesit komunalë gjithashtu i kanë raportuar OSBE-së probleme me moslëshimin e dokumenteve në gjuhën e tyre nga shërbimet e ndryshme komunale, përfshirë kadastrin, zyrat e tatimit, zyrat e gjendjes civile dhe të regjistrimit të automjeteve, si dhe shtëpitë e shëndetit që administrohen nga institucionet e Kosovës.⁷⁹ Është raportuar për probleme edhe sa i përket ofrimit të shërbimeve dhe komunikimit në gjuhën turke.⁸⁰ Ende po ka vështirësi për të gjetur dhe punësuar persona të cilët i flasin gjuhët zyrtare, ngase vetëm punonjësit e gjeneratës më të vjetër janë gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive si në gjuhën serbe ashtu edhe atë shqipe. Aktualisht, të vetmin kurs për mësimin e gjuhës shqipe dhe asaj serbe për nëpunësit civil të Kosovës e ofron Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakica Kombëtare në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ).⁸¹

Në nivel qendror, përkthimi me gojë në të dyja gjuhët zyrtare, si edhe në atë turke, sigurohet për të gjitha takimet e komisioneve parlamentare dhe seancat plenare të Kuvendin e Kosovës (KK), dhe të gjitha dokumentet shpërndahen me kohë në të dyja gjuhët zyrtare. Në nivelin lokal, monitorimi i realizuar nga OSBE-ja ka theksuar disa përmirësime sa i përket sigurimit të përkthimit me gojë gjatë seancave të kuvendit të komunës⁸², që tani po sigurohet në 28 komuna shumetnike. Megjithatë, qasja në shërbime të përkthimit me gojë dhe me shkrim në të gjitha gjuhët zyrtare mbetet problematike për shkak të numrit të pamjaftueshëm të përkthyesve të punësuar në nivel komunal, dhe përkthimet me cilësi së dobët vazhdon t'i ndikojnë negativisht komunitetet në disa mënyra.⁸³ Shqyrtimi i OSBE-së të tabelave në të gjitha gjuhët zyrtare të vendosura në objektet publike komunale ka shpalosur dallime në praktika.⁸⁴ Dispozitat ligjore për gjuhët janë respektuar plotësisht në shumicën e komunave, megjithatë, në nëntë komuna⁸⁵ ato janë respektuar vetëm pjesërisht (për shembull, tabelat në hyrje të objekteve komunale ishin në të gjitha gjuhët zyrtare, por ato brenda objekteve vetëm në një të gjuhë) dhe në katër komuna⁸⁶ (krahas katër komunave veriore të Kosovës) ishin

⁷⁷ Përveç në gjuhën shqipe, gjuhën serbe dhe atë angleze. Përdorimi i alfabetit cirilik është bërë i mundshëm tashmë në gjithë komunat e Kosovës, dhe softueri ngarkon gjithashtu edhe formularët në gjuhën turke dhe atë boshnjake në komunat ku pjesëtarët e këtyre komuniteteve përbëjnë më se 5 për qind të popullsisë.

⁷⁸ Shumë prej problemeve të vëna në dukje në raportin e OSBE-së 2014 për pajtueshmërinë gjuhësore ende vazhdojnë, shih raportin “*Respektimi i të drejtave gjuhësore nga komunat e Kosovës*”, (Qershor, 2014), <http://www.osce.org/sq/kosovo/120011> (qasur më 28 tetor 2015).

⁷⁹ *Po aty*, Kreu 4.3.

⁸⁰ Për shembull, gjuha turke është gjuhë zyrtare në Prizren, megjithatë është raportuar për probleme në zyrën për leje ndërtimi ku komunikimi me publikun zhvillohet me ndihmën e përkthyesit. Në Gjilan/Gnjilane, Mitrovicë të Jugut/Mitrovica dhe Vushtrri/Vučitran, ku gjuha turke është gjuhë në përdorim zyrtar, shumica e nëpunësve civilë të cilët punojnë në ZKKK, zyrën për leje të ndërtimit, zyrën e gjendjes civile, qendrat për punë sociale, zyrën për ndihmë juridike falas dhe qendrën e punësimit nuk e flasin gjuhën turke.

⁸¹ Projektin po e zbaton Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave, dhe deri në qershor të vitit 2015 është shtrirë në 17 komuna të përziera. Për më shumë informata, shih: <http://www.ecmikosovo.org/?p=6232>.

⁸² Neni 7.3 I Ligjit për përdorimin e gjuhëve, shënimi i 4-të i mësipërm.

⁸³ Gjersa pesë komuna nuk kanë fare përkthyes, 33 komunat tjera kanë të punësuar vetëm një ose dy, me përjashtim të komunës së Prizrenit që i ka katër.

⁸⁴ OSBE i ka verifikuar tabelat Brenda dhe jashtë zyrave publike komunale, në hyrje të zyrave publike dhe në qendrat e kujdesit parësor shëndetësor.

⁸⁵ Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Shtime/Štimlje dhe Suharekë/Suva Reka.

⁸⁶ Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Elëz Han, Malishevë/Mališevo dhe Parteš/Partesh.

vetëm në gjuhën e shumicës. Progres i dukshëm është bërë me tabelat me toponimet e komunave, fshatrave, rrugëve dhe rrugicave komunale në gjuhët zyrtare, shumica e të cilave janë në përputhje me detyrimet ligjore për përdorimin e gjuhëve⁸⁷, ndonëse ende ka probleme me gabimet drejtshkrimore dhe/ose dëmtimet e tabelave. Shtatë komuna⁸⁸ (përveç katër komunave veriore) vazhdojnë të mos i respektojnë detyrimet për përdorimin e gjuhëve.

Komisioneri për gjuhët dhe strukturat tjera të ngjashme

ZKGGJ ka bërë përpunim të madh në zbatimin e mandatit të vet. Përpunim është bërë në punësimin me sukses të punonjësve⁸⁹, krijimin e faqes së internetit⁹⁰, duke përfshirë këtu vënien në dispozicion edhe të një formulari për ankesa në të, si dhe një fushatë për media për të promovuar mandatin dhe vizibilitetin e ZKGGJ-së.⁹¹ Monitorimi i realizuar nga OSBE-ja thekson se vetëdijesimi ka kontribuar që publiku të adresojnë më shumë ankesa në ZKGGJ⁹², shumica e të cilave janë zgjidhur. Zhvillim tjetër pozitiv është caktimi i personave kontaktues për gjuhët në 32 komuna⁹³. Veç kësaj, ZKGGJ ka qenë përkrahësi kryesor i përfshirjes si të gjuhës turke ashtu edhe asaj boshnjake në formularët dhe shabllonët e gjendjes civile (siç u përmend më sipër). Në mars të vitit 2015, ZKGGJ i prezantoi gjetjet kryesore për statusin e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë⁹⁴, duke arritur në përfundimin se burimet e kufizuara financiare, teknike dhe njerëzore, si dhe shkalla e ulët e vetëdijes për detyrimet ligjore, vazhdojnë të jenë pengesë për respektimin e detyrimeve për përdorimin e gjuhëve në institucione publike, duke vënë theksin mbi trendin brengosës drejt njëgjuhësisë në mesin e nëpunësve civilë të Kosovës. Në vitin 2015, ZKGGJ nisi procesin e hartimit të një strategjie afatmesme (2016-2020) për zbatimin sistematik të ligjit të lartpërmendur, që pritet të finalizohet deri në fund të vitit 2015.

Sfidat e mbetura

Institucionet e nivelit qendror dhe lokal në Kosovë vazhdojnë të mos sigurojnë respektim të

⁸⁷ Ky është kryesisht rezultat i projektit për unifikimin dhe digjitalizimin e sistemit të adresave të realizuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në kuadër të projektit “Përkrahje Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe sistemit të unifikuar të adresave”.

⁸⁸ Gjilan/Gnjilane, Hani i Elezit/Elez Han, Malishevë/Mališevo, Mamuşa/Mamushë/Mamuša, Parteš/Partesh, Rahovec/Orahovac dhe Ranilug/Ranillug.

⁸⁹ Deri në qershor të vitit 2015, ZKGGJ ka pasur të punësuar gjashtë punonjës zyre, ndërsa një vend ka qenë ende i paplotësuar.

⁹⁰ Në dispozicion në gjuhën shqipe në <http://www.komisioneri-ks.org>; dhe në gjuhën serbe në <http://www.poverenik-ks.org>. Që nga prilli i vitit 2014, faqja është në dispozicion edhe në gjuhën boshnjake dhe atë turke.

⁹¹ Fushatat e vetëdijesimit për të drejta gjuhësore janë rritur gradualisht gjatë periudhës 2013–2014, dhe kanë përfshirë edhe shpërndarjen e materialeve informuese, spote në TV dhe radio, aktivitete që kanë qenë të mbështetura nga partnerët ndërkombëtarë, përfshirë OSBE dhe UNDP.

⁹² Në vitin 2012, ZKGGJ i trashëgoi katër ankesa nga Komisioni për gjuhët, ndërsa në vitin 2013 pranoi 12 ankesa e deri në fund të vitit 2014 i pranoi gjithsej 54. Gjithë ankesat janë zgjidhur, përveç pesë sish që janë ende nën shqyrtim dhe janë bartur në 2015.

⁹³ Caktimi i personave kontaktues për gjuhët në nivel të komunës rregullohet me nenin 15 të Rregullores nr. 07/2012 për themelimin e Zyrës së Komisionerit për Gjuhët. Komunitat janë të obliguara me ligj që ta caktojnë një person kontaktues për përdorimin e gjuhëve me detyrën për t'i ndihmuar ZKGGJ-së ta zbatojë mandatin. Pjesa dërrmuese e këtyre personave kontaktues nuk mbajnë pozita drejtuese dhe nuk kanë trajnime adekuate për rolin dhe funksionet e tyre. Personat kontaktues komunal për gjuhët nuk janë caktuar në katër komunitat veriore (Mitrovica/Mitrovicë e Veriut, Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan), dhe në Suharekë/Suva Reka e Rahovec/Orahovac.

⁹⁴ Raport i ZKGGJ, “Monitorim dhe vlerësim i të drejtave gjuhësore në Kosovë” http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/Anglisht_Finale_160315.pdf. (qasur më 28 tetor 2015).

plotë të detyrimeve për përdorimin e gjuhëve institucionet vazhdojnë të mos jenë sa duhet të informuara për sa u përket përgjegjësi të tyre, dhe opinioni publik ngjashëm ka vetëdijesim të ulët të drejtave të gjuhësore. Të gjitha institucionet e Kosovës kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve për shërbimet dhe funksionet gjuhësore dhe duhet të theksohet se kjo ngritje kapacitetesh do të kërkojë kohë për të treguar rezultate të përhapura. Deri më tani tri fusha kryesore kanë mbetur të patrajtuara: aftësimi dhe certifikimi i përkthyesve, ashtu që të sigurohet punësim i përkthyesve të zotë; përpilimi i fjalorëve modernë në internet dhe veglave të tjera për përkthim; si dhe zhvillimi i sistemeve për sigurim të cilësisë, veçanërisht për tekstet ligjore, përmes zhvillimit dhe shfrytëzimit të teknikave të hartimit legjislativ në shumë gjuhë.

2. ARSIMI

Rekomandimi 4

Të përmirësohet cilësia e arsimit në gjuhët e komuniteteve numerikisht më të vogla dhe të identifikohen zgjidhje të përshtatshme për pengesat e mbetura ndaj qasjes në arsim të fëmijëve që u përkasin komuniteteve goran, rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. Të rishikohen materialet dhe metodologjia mësimore për t'i përshtatur për një shoqëri shumëetnike.

Situata e tanishme

Pa asnjë përparim në krijimin e një sistemi të integruar të arsimit, institucionet e arsimit në Kosovë vazhdojnë të administrohen nëpërmjet dy sistemeve paralele të operuar nga institucionet e Prishtinës/Pristina dhe ato të Beogradit, përkatësisht. Këto sisteme ofrojnë mundësi të ndryshme të shkollimit në gjuhën amtare për pjesëtarët e komuniteteve numerikisht më të vogla. Pjesëtarët e komuniteteve priren që në të shumtën e rasteve ta zgjedhin njërin nga sistemet varësisht nga vendndodhja e tyre dhe në masë më të vogël në bazë të gjuhës dhe/ose përkatësisë fetare të tyre. Institucionet e Kosovës ofrojnë shkollim në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake. Sistemi nën administrim të Serbisë ofron shkollim në gjuhën serbe, ndërsa mësimi në gjuhën rome mbahet në disa shkolla në kuadër të të dyja sistemeve të arsimit.

Sipas sistemit që drejtohet nga institucionet e Kosovës, mësimdhënia në gjuhë turke dhe boshnjake është përgjithësisht në dispozicion të komuniteteve në komunat ku ato jetojnë, ndërsa komunat ofrojnë lëndë mësimi edhe kur numri i nxënësve është më i ulët sesa minimumi i përcaktuar.⁹⁵ Sidoqoftë, përfaqësuesit e komunitetit turk dhe atij boshnjak të Kosovës vazhdojnë të ankohen se nuk kanë tekste shkollore, posaçërisht për nxënësit e

⁹⁵ Ndonëse ka paqartësi për minimumin e përcaktuar (Udhëzimi administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve dhe raportin mësimdhënës-nxënës, në dispozicion në <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/22-2013-ua.pdf>), shumica e komunave ofrojnë mësim për klasat me më pak nxënës sesa minimumi i nevojshëm (p.sh. në Gjilan/Gnjilane dhe Mitrovicë / Mitrovica Jugore në gjuhën turke, në Dragash/Dragaš në gjuhën boshnjake dhe në Prizren në të dyja gjuhët). Megjithatë, arsimi në gjuhën turke nuk është në dispozicion në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, duke qenë se nuk është parashtruar asnjë kërkesë zyrtarë për një gjë të tillë. Arsimi në gjuhën boshnjake nuk është në dispozicion në komunat Mitrovica/Mitrovicë Veriore dhe Leposavić/Leposaviq, ku komuniteti boshnjak vijon arsimin në gjuhën serbe në institucionet që drejtohen nga Beogradi.

arsimit të mesëm të lartë e që do të thotë se në praktikë mësimdhënësit shpesh mbështeten në tekstet shkollore që importohen.⁹⁶

Komuniteti goran, kroat, ashkali, egjiptian dhe malazez, të gjithë të Kosovës, nuk kanë qasje në lëndët shkollore të posaçme për komunitetet që u mundësojnë atyre të ruajnë identitetin e tyre. Qasja fizike në arsim mbetet problem për disa komunitete të vogla, duke përfshirë nxënësit goranë të Kosovës të cilët jetojnë në vendbanime të largëta dhe nxënësit romë, ashkali dhe egjiptian të Kosovës nga Mitrovica /Mitrovica Jugore të cilët vazhdojnë të përballen me vështirësi për të udhëtuar në shkollat që gjenden në Mitrovica/Mitrovicë Veriore.

Disa zhvillime pozitive u shënuan gjatë periudhës për të cilën raportohet, lidhur me disponueshmërinë e lëndëve të mësimi në gjuhën rome e që përfshijnë elemente të kulturës dhe historisë rome, kurse MASHT-i ka hartuar dhe botuar tekste shkollore në gjuhën rome më 7 prill 2014.⁹⁷ Komuna e Prizrenit siguroi lëndë të gjuhës rome në katër shkolla (që pastaj u zgjerua për të përfshirë edhe një shkollë tjetër nga raporti i fundit për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve), siguroi pagë për mësimdhënësit, si dhe ka plane për aplikimin e lëndëve të tilla edhe në pesë komuna të tjera gjatë vitit shkollor 2015–2016.⁹⁸ Megjithatë, fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës vazhdojnë të përballen me sfida në qasjen në arsim cilësor dhe janë joproporcionalisht të prekur nga mosregjistrimi, braktisja, analfabetizmi në shkallë të lartë dhe arritje të ulëta arsimore.⁹⁹ Në tetor të vitit 2012, MASHT-i nxori një Udhëzim Administrativ duke i dhënë institucioneve arsimore në nivel komunal përgjegjësi për themelimin dhe funksionalizimin e “ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e detyrueshëm” (EPRMB).¹⁰⁰ Më tutje, MASHT-i, në tetor 2014, zhvilloi dhe aprovoi termat e referencës për të ndihmuar në operimin e ekipeve EPRMB. Duke qenë të obligueshme në nivel shkolle dhe komune, EPRMB-të mëtojnë të bashkërendojnë veprimet për t’i trajtuar braktisjet dhe për ta luftuar regjistrimin e ulët dhe pritej se do të ofronin mbështetje të veçantë për fëmijët e këtyre tre komuniteteve. Megjithatë, vlerësimet e OSBE-së në mars të vitit 2014 theksuan se vetëm një e pesta e EPRMB-ve ishin themeluar ndërsa shumë prej tyre ende nuk kanë mbajtur mbledhje të rregullta dhe nuk e kanë të qartë rolin e tyre. Në një hap tjetër për të mbështetur nevojat arsimore të fëmijëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, MASHT me partnerët ndërkombëtarë siguruan 500 bursa për shkollat e mesme dhe 33 bursa universitare gjatë vitit shkollor 2014-2015. Megjithatë ndërmjetësit e arsimit dhe qendrat e mësimnxënies, të cilat ofrojnë mbështetje të rëndësishme për fëmijët e këtyre tre komuniteteve, ende

⁹⁶ Mbledhje e Këshillit Konsultativ për Komunitetet (KKK) më 27 shkurt 2015; mbledhja e grupit punues për arsim të KKK më 14 maj 2015; intervista me përfaqësuesit e komunitetit, drejtorët e shkollave dhe drejtorët e drejtorive komunale të arsimit që u zhvilluan në maj dhe qershor të vitit 2015.

⁹⁷ *Romani Chib 1* (Gjuha rome 1) nga Latif Demiri; teksti i dytë shkollor është duke u hartuar.

⁹⁸ Mbështetur nga projekti i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës “përkrahja e arsimit dhe mirëkuptimit ndërkulturor”, lënda e gjuhës rome do të fillojë edhe në Pejë/Peć, Gjakovë/Đakovica, Ferizaj/Uroševac, Obiliq/Obilić dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje. MASHT u zotua për të mbuluar pagat e mësimdhënësve deri në fund të vitit 2015, duke parashikuar se komunat do të marrin përsipër përgjegjësinë financiare në vitin 2016.

⁹⁹ Instituti Pedagogjik i Kosovës: *Fëmijët jashtë shkollës në Kosovë: Studim bazë për praktikën e parandalimit dhe reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë* (2014), http://www.ipk-rks.net/en_publicimet_meshume.php?publicimet_id=87.

¹⁰⁰ Udhëzimi administrativ nr. 19/2012 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e detyrueshëm, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-19-2012-neë.pdf>.

vazhdojnë të drejtohen nga OJQ-të dhe përpjekjet për të institucionalizuar këto qendra dhe rolin e ndërmjetësve deri më tani kanë qenë të pasuksesshme. Një shqetësim shtesë janë praktikat diskriminuese, duke përfshirë ngacmimin, në shkollat e sistemit të Serbisë dhe atyre të Kosovës, si dhe rastet e segregacionit të nxënësve që i përkasin këtyre tre komuniteteve¹⁰¹ e që i janë nënshtruar një procesi gjyqësor, i cili është në vazhdim e sipër, kundër komunës së Gjakovës/Đakovica¹⁰².

Mundësitë e arsimit të lartë në gjuhët e komuniteteve në numër më të pakët mbesin të kufizuara, duke i detyruar ato të ndjekin arsimimin e mëtutjeshëm diku tjetër. Mosnjohja e diplomave dhe certifikatave, posaçërisht për ata të cilët shpresojnë të kalojnë nga sistemi i Serbisë në atë të Kosovës apo anasjelltas, vazhdon të paraqet problem që ndikon në aftësinë e studentëve për të pasur qasje në tregun e punës. Përkundër disa nismave, është shënuar shumë pak përparim gjatë periudhës për të cilën raportohet për këtë çështje të rëndësishme. Ndonëse dialogu i Brukselit nisi procesin e njohjes së diplomave¹⁰³, skadimi i financimit për ndërmjetësuesin, OJQ SPARK, ka rezultuar në pasiguri për mekanizmat e njohjes¹⁰⁴. Institucionet e Kosovës gjithashtu filluan të shqyrtojnë mundësitë e trajtimit të problemit të njohjes së diplomave që lëshohen nga universiteti që gjendet në Mitrovica/Mitrovicë Veriore, faktor i rëndësishëm për punësimin e serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera. Financimi nga Norvegjia, përmes Zyrës për Çështje të Komuniteteve (ZÇM) të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) dhe OJQ-së Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë, në prill të vitit 2015 çoi në një koncept dokument për procedurat e aplikimit në punë në institucionet publike për pjesëtarët e komuniteteve të cilët kanë diploma që janë lëshuar nga Universiteti në Mitrovica/Mitrovicë Veriore, dhe një ekip i caktuar zyrtarisht aktualisht po punon për të hartuar aktin normativ për krijimin e procedurave.

Gjuha shqipe si gjuhë e huaj mësohet si lëndë fakultative në shkollat e drejtuara nga MASHT, të cilat ofrojnë mësimdhënie në gjuhën boshnjake ose turke. Megjithatë, shkollat janë pa mësimdhënës të specializuar apo materiale mësimore për mësim të shqipes si gjuhë joamtare. Për më tepër, nxënësit në Kosovë ende nuk e kanë opsionin e mësimin të gjuhës serbe si gjuhë e dytë zyrtare si dhe nuk ekziston ndonjë plan program për këtë lëndë.¹⁰⁵ Kosova ka shënuar përparim në reformimin e sistemit arsimor duke zhvilluar plan programe të reja në shtatë fusha të plan programeve, duke përfshirë metodat e mësimdhënies shumetnike dhe përfshirëse. MASHT-i raportoi se përfaqësuesit e komuniteteve u konsultuan në procesin e hartimit të këtij plan programi. Monitorimi i realizuar nga OSBE-ja ka regjistruar se plan-programi i ri u pilotua në 94 shkolla gjatë vitit shkollor 2014/2015, duke përfshirë shkollat ku mësimdhënia është në gjuhën turke dhe boshnjake. Mirëpo zbatimi i plotë i plan programit të ri me gjasë nuk do të ndodhë para vitit 2016 dhe MASHT tek duhet të fillojë me rishikimin e teksteve shkollore për të pasqyruar këtë plan program të ri.

Sfidat e mbetura

¹⁰¹ Intervista me përfaqësuesit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës që u zhvilluan nga OSBE-ja në maj dhe qershor të vitit 2015.

¹⁰² Shih: http://www.ecmikosovo.org/ep-content/Publications/Press_releases_and_information_bulletin/2013-01_ECMI_Kosovo_Information_Bulletin_Segregation_in_Education_in_Gjakova/eng.pdf.

¹⁰³ Udhëzimi administrativ nr. 09/2015 i MASHT njeh diplomat e lëshuara nga universitetet serbe përmes procesit që është nisur nga dialogu i Brukselit.

¹⁰⁴ OJQ SPARK ka punuar si ndërmjetëse, duke pranuar kërkesat për njohje të diplomave nga të diplomuarit e prekur serbë duke i përcjellë ata tek Asociacioni i Universiteteve Evropiane për vërtetim ndërkombëtar.

¹⁰⁵ Në sistemin arsimor të drejtuar nga Beogradi, lënda e gjuhës shqipe si gjuhë e huaj ofrohet vetëm në tre shkolla fillore në komunën e Dragashit/Dragaš e që vijohet nga komuniteti goran i Kosovës.

Nxënësit për të cilët mësimdhënia bëhet në gjuhën e komuniteteve nuk kanë zgjidhje të mësimi të njëres nga dy gjuhët zyrtare në Kosovë. Deri më sot nuk ka pasur përpjekje të veçanta për të mbështetur mësimin e të dyja gjuhëve zyrtare për folësit të cilët nuk i flasin këto gjuhë; ende nuk zbatohet mësimi i gjuhës serbe si gjuhë joamtare si dhe nuk ka mësimdhënës të specializuar për programet e trajnimit për mësimdhënësit e gjuhës shqipe si gjuhë e huaj. Mësimdhënësit e gjuhës romë gjithashtu kanë mungesë aftësimi. Çështjet që kanë të bëjnë me disponueshmërinë dhe shpërndarjen e kopjeve të teksteve shkollore në gjuhën boshnjake dhe turke ende nuk janë zgjidhur dhe mbikëqyrja e cilësisë dhe standardeve të mësimdhënies në gjuhën boshnjake dhe turke duhet të përmirësohet. Janë bërë hapa shumë të kufizuar dhe nuk ka pasur konsultime të gjera me komunitetet për hartimin e moduleve arsimore të veçanta për komunitetet përkitazi me kulturën, historinë dhe traditat e komuniteteve të Kosovës në numër më të vogël për t'ju mundësuar ruajtjen e identitetit dhe/ose gjuhës së tyre. Vazhdon të ketë pengesa për shkollimin e fëmijëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, duke përfshirë zbatimin e paqëndrueshëm të masave për të luftuar braktisjen, si dhe mungesa e politikave efektive dhe përkrahje me buxhet për masat që janë dëshmuar si dobiprurëse në Kosovë, duke përfshirë qendrat e mësimnxënies dhe ndërmjetësuesit e shkollës.

Ekzistimi i dy sistemeve shkollore me plan programe dhe tekste shkollore të ndara, duke përfshirë pasqyrimet historike në kundërshtim me njëra-tjetrën, vazhdojnë të pengojnë zhvillimin e një shoqërie shumetnike dhe lypset përkushtimin dhe veprimin nga institucionet e Prishtinës/Pristina dhe Beogradit. Sfidat e mbetura për institucionet përfshijnë zhvillimin, në konsultim me komunitetet, modalitetet e mundshme të bashkëpunimit mes dy sistemeve për çështjet që prekin qasjen e komuniteteve në arsim, të tilla si njohja e diplomave/certifikatave në të gjitha nivelet e arsimit dhe ndarjen e ndërtesave.

1. TË DREJTAT SOCIO-EKONOMIKE DHE PJESËMARRJA

Rekomandimi nr. 5

Të garantohet përfaqësimi efektiv i komuniteteve pakicë në Kuvend, duke përfshirë komunitetin kroat dhe atë malazez, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Kosovës, përmes ndarjes së një numri të duhur të ulëseve të garantuara. Të sigurohen mundësi efektive për personat që i përkasin të gjitha komuniteteve pakicë, duke përfshirë ato në numër të vogël, për pjesëmarrje në proceset gjegjëse të vendimmarrjes në nivel qendror dhe lokal si dhe të sigurohet se të gjitha përpjekjet përmirësojnë integrimin në vend të zhvillimit të strukturave të ndara.

Gjendja e tanishme

Në Kuvendin e Kosovës (KK), përfaqësimi i komuniteteve është i siguar përmes 20 ulëseve të garantuara me Kushtetutë dhe në këtë cikël zgjedhor subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet joshqiptare nuk arritën të fitojnë ulëse shtesë, përtej atyre të garantuara me kuotë, që janë plotësuar nga shtatë gra dhe 13 burra. Kuvendi i Kosovës u shpërnda me 7 maj 2014 dhe legjislatura e re nuk u themelua deri në dhjetor të vitit 2014, si pasojë e procesit të zgjatuar politik të ndërtimit të koalicionit dhe konsensusit. Nga 10 ulëse të garantuara për komunitetin serb të Kosovës, Nisma Qytetare Srpska i fitoi nëntë ulëse (katër gra dhe pesë burra) dhe Partia Demokratike Përparimtare e fitoi një ulëse (një burrë). Dhjetë ulëset e tjera për komunitetet u fituan nga Partia Demokratike Turke e Kosovës, dy ulëse (një grua dhe një burrë), Koalicioni Vakati i boshnjakëve të Kosovës me dy ulëse (një grua dhe një burrë), dhe partitë vijuese me nga një: dhe Partia e Re Demokratike (një grua), Partia Demokratike e

Ashkalive të Kosovës (një burrë), Partia Liberale Egjiptiane (një burrë), Partia e Ashkalive për Integrim (një burrë), Koalicioni për Gorën (një burrë) dhe Partia e Re Rome (një burrë). Përkundër njohjes zyrtare të komunitetit kroat dhe atij malazez në Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve¹⁰⁶, miratuar në dhjetor të vitit 2011, nuk janë bërë ndryshimet gjegjëse kushtetuese për t'ju siguruar këtyre komuniteteve ulëset e rezervuara në Kuvendin e Kosovës.

Sikurse në legjislaturat e mëparshme, Kuvendi i Kosovës zbatoi mekanizma gjegjës të përcaktuar për mbrojtjen dhe promovimin e komuniteteve joshqiptare¹⁰⁷, pra dy nënkryetarët e Kryesisë së Kuvendit nga këto komunitete¹⁰⁸ dhe komisionin e përhershëm për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim. Përveç kësaj, të gjitha 13 komisionet e përhershme dhe funksionale të Kuvendit të Kosovës kanë emëruar nënkryetarin e dytë të përcaktuar nga komunitetet joshqiptare. Respektimi i përdorimit të gjuhës në punën e Kuvendit të Kosovës është vlerësuar si përgjithësisht i mirë, ndonëse ka probleme me cilësinë e përkthimeve të ligjeve.¹⁰⁹ Në maj të vitit 2014, Kuvendi i Kosovës miratoi deklaratën për partneritet me organizatat e shoqërisë civile, pra kjo është një nismë e re. Organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në bazën e të dhënave të Kuvendit të Kosovës për organizatat e shoqërisë civile u ftuan që të bëjnë kërkesë për anëtarësim në një grup punues, për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë e Kuvendit të Kosovës duke përfshirë shqyrtimin e projektligjeve dhe dëgjimet publike me qëllim të dhënies së ekspertizës dhe informatave kthyes nga pikëpamja e shoqërisë civile. Nga nëntë anëtarët e grupit punues nga organizatat e shoqërisë civile, vetëm njëri, burrë, ishte nga komunitetet joshqiptare, gjegjësisht komunitetit boshnjak të Kosovës. Dështimi për të parashtruar kërkesë për anëtarësim deri në afatin e shpallur parandaloi pjesëmarrjen më të madhe të organizatave të tjera të shoqërisë civile, ndonëse janë bërë përpjekje për të përfshirë një spektër më të gjerë të organizatave të shoqërisë civile në bazën e të dhënave të Kuvendit të Kosovës¹¹⁰.

Institucionet e pavarura që i raportojnë Kuvendit të Kosovës dhe/ose institucioneve të Kosovës, e që janë 33¹¹¹, gjithashtu kanë shënuar përparim në lidhje me përbërjen e tyre dhe i kanë respektuar kërkesat për emërimin e anëtarëve joshqiptarë në borde. Deri më 30 qershor 2015, 14 institucione të tilla kishin themeluar borde duke i respektuar kërkesat me emërimin e një apo dy anëtarëve nga komunitetet joshqiptare, kryesisht serbë të Kosovës por edhe turq apo boshnjakë të Kosovës.

Në nivel qendror, mekanizmi kryesor që siguron kontakt të rregullt mes përfaqësuesve të komuniteteve dhe institucioneve të Kosovës dhe që funksionon nën kujdesin e Zyrës së

¹⁰⁶ Shih fusnotën 3 më sipër.

¹⁰⁷ Siç përcaktohet me Rregulloren e Punës të Kuvendit të Kosovës; neni 63, komisionet e përhershme dhe funksionale.

¹⁰⁸ Një pozitë e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës është e rezervuar për komunitetin serb të Kosovës dhe pozita tjetër është e rezervuar për komunitetin tjetër joshqiptar: në këtë legjislaturë, të dyja pozitat janë zënë nga një serb i Kosovës, përkatësisht nga një boshnjak i Kosovës.

¹⁰⁹ Ju lutem shihni rekomandimin 9 dhe rekomandimin 3 për një diskutim të mëtutjeshëm të këtij problemi.

¹¹⁰ Për shembull, Kuvendi i Kosovës zgjati afatin për aplikim dy herë, dhe (me mbështetjen e OSBE-së) publikoi informacionin e duhur të regjistrimit dhe aplikimit në portalet e lajmeve në internet, duke përfshirë edhe në gjuhën serbe, në prill 2015.

¹¹¹ Për shembull, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Agjencia Kosovare e Pronës, Agjencia kundër Korrupsionit, Institucioni i Avokatit të Popullit, Komisioni i Pavarur për Media, Banka Qendrore e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, etj.

Presidentit, Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK), në shtator të vitit 2014 emëroi anëtarët e ri për një mandat 2 vjeçar dhe mbajti mbledhje në baza të rregullta. KKK ka në përbërje 25 anëtarë, të cilët përfaqësojnë nëntë komunitete; nga këta 25, vetëm pesë janë gra. Që nga rritja e vogël e buxhetit të KKK-së në vitin 2013, Sekretariati i KKK është shtuar nga dy në katër punonjës (tre meshkuj dhe një grua që e udhëheq Sekretariatit)¹¹². Gjatë periudhës për të cilën raportohet, KKK-ja nxori rekomandime për institucionet në çështjet me rëndësi për komunitetet dhe shqyrtoi tre projektligje. Megjithatë ende mungon konsultimi sistematik me KKK në fazat e hershme të hartimit të legjislacionit dhe zhvillimit të politikave.¹¹³ Sipas monitorimit të OSBE, KKK-ja gjithashtu ende nuk raporton tek mekanizmat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, siç përcaktohet me ligj dhe kushtetutë, dhe nuk ka ndërmarrë konsultime themelore apo ndonjë veprimtari ndërgjegjësimi për të mbështetur punën e vet për të përfaqësuar në mënyrë efektive interesat e komuniteteve joshqiptare. Ndonëse anëtarët e KKK gjithnjë e më shumë po ftohen që të marrin pjesë në grupet e ndryshme qeveritare të punës, kjo shpesh bëhet vetëm pas nxitjes nga organizatat ndërkombëtare. Ngjashëm, ministritë dhe drejtoritë e Kosovës kanë përkrahur konsultimet me komunitetin para ndryshimit të ligjeve gjegjëse apo zhvillimit të strategjive, por edhe në këtë rast konsultimet e tilla shpesh janë nxitur nga organizatat ndërkombëtare.¹¹⁴ Përfundimisht, KKK ende nuk ka përfaqësuar të duhur gjinor duke qenë se vetëm 4 prej 24 përfaqësuesve aktualë të komuniteteve të emëruar janë femra.¹¹⁵

Sa i përket emërimeve në nivel udhëheqës në institucionet e Kosovës, situata është si në vijim: një nga tre zëvendëskryeministrat është joshqiptar, gjegjësisht serb i Kosovës; nga 19 ministrat e emëruar katër janë nga komunitetet joshqiptare, pra një më shumë sesa kuota e përcaktuar (dy serbë të Kosovës, të emëruar si Ministër për Komunitete dhe Kthim dhe Ministër për Administrimin e Pushtetit Lokal; një turk i Kosovës i emëruar si Ministër i Administratës Publike dhe një boshnjak i Kosovës i emëruar si ministër pa resor). Në lidhje me zëvendësministrat e emëruar, në fund të qershorit 2015, tre ishin joshqiptarë, më pak se gjatë nga sa përcaktohet me kushtetutë: një rom i Kosovës në MKK, një ashkali i Kosovës në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport (MKRS), dhe një boshnjak i Kosovës në Ministrinë e Diasporës¹¹⁶. Vlen të theksohet që pozita e drejtorit të ZÇM ka mbetur e paplotësuar nga

¹¹² KKK-ja përbëhet nga sekretari i përgjithshëm, dy zyrtarë ligjorë dhe një zyrtar për marrëdhënie me publikun. Buxheti i KKK-së në vitin 2012 ishte 78,785 Euro, pastaj u shtua për 8,600 Euro dhe arriti në shumën 87,385 Euro në vitin 2013.

¹¹³ KKK-ja ka diskutuar ndryshimet-plotësimet e propozuara të Ligjit për institucionin e avokatit të popullit, Ligjit për barazi gjinore dhe Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e komuniteteve. Megjithatë, ai nuk është konsultuar e as nuk ka shqyrtuar apo dhënë komentet për legjislacionin tjetër gjegjës apo nismat e politikave që janë zhvilluar apo miratuar gjatë periudhës për të cilën raportohet, të tilla si koncepti dokumenti i qeverisë për procedurat e parashtrimit të kërkesës për punë në institucionet publike për pjesëtarët e komuniteteve që kanë diplomë të lëshuar nga Universiteti i Mitrovicës/Mitrovicës Veriore, projektligji për trashëgiminë kulturore ose Ligji për ndërmarrjet publike.

¹¹⁴ Për shembull, në prill të vitit 2015 OSBE-ja mbështeti Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal për të mbajtur një punëtori konsultative me mekanizmat për pjesëmarrjen e komuniteteve për t'i dhënë sugjerimet e tyre për ndryshim-plotësimet e Ligjit për vetëqeverisje lokale që ishte planifikuar për vitin 2015. Ngjashëm, në maj të vitit 2015 OSBE-ja mbështeti Zyrën për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për të konsultuar përfaqësuesit e komuniteteve për politikën e integritit të romëve, ashkalive dhe egjiptianë të Kosovës pas vitit 2015.

¹¹⁵ Statuti i KKK përcakton përfaqësimin gjinor për listat e kandidatëve dhe të votimit, por jo edhe për anëtarët e tij; ai po ashtu përcakton kompetencën e Presidentit për të refuzuar emërimin e të emëruarve nëse është e nevojshme për të siguruar pjesëmarrje të barabartë gjinore.

¹¹⁶ Që nga përfundimi i periudhës së mbuluar nga ky raport, janë bërë e dhe shtatë emërimet tjera në shtator 2015, gjë që ka sjellë më shumë zëvendësministra nga komunitetet joshqiptare se sa që kërkohet me ligj, duke përfshirë këtu: një boshnjak të Kosovës në MASHT, pesë serbë të Kosovës në Ministrinë e Punës dhe

dhjetori i vitit 2014 deri në gusht të vitit 2015. Nga të gjitha këto poste të nivelit udhëheqës, vetëm një nga të emëruarit është femër, zëvendësministre në MKRS nga komuniteti ashkali i Kosovës.

Në nivel komunal janë katër mekanizma me mandat të veçantë për të siguruar pjesëmarrjen e komuniteteve në punët publike mbi vendimet që i prekin ato: komiteti për komunitete (KK), zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) dhe posti i nënkryetarit të komunës (NKK) dhe ai i zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete (ZKKKK).¹¹⁷ Monitorimi i bërë nga OSBE-së ka identifikuar përparim dhe përmirësim që nga botimi i raportit të fundit për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve në 2012. Vlen theksuar që KK dhe ZKKK tashmë janë themeluar gjithandej Kosovës, me disa përjashtime të vogla.¹¹⁸ ZKKKK tashmë janë emëruar në të gjitha komunat që përcaktojnë këtë pozitë, përveç njëres.¹¹⁹ NKK tashmë është emëruar në gjashtë nga shtatë komunat ku kjo pozitë përcaktohet, ndërsa shtatë komuna të tjera kanë emëruar NKK si një pozitë fakultative për shkak se kanë më pak se dhjetë për qind të komuniteteve në pakicë numerike në komunë. Ndonëse këto mekanizma kanë përfituar nga legjislacioni i ri dhe udhëzimet e politikave gjatë periudhës për të cilën raportohet¹²⁰, korniza ligjore që rregullon mekanizmat në fjalë duhet të fuqizohet për të mundësuar pjesëmarrjen kuptimplotë të komuniteteve në punët publike. Po ashtu nevojitet mbikëqyrje, mbështetje dhe përkrahje më e madhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për mekanizmat gjegjës. Ende nuk ka pjesëmarrje kuptimplotë të komuniteteve në vendimmarrjet relevante, kjo meqë shumë mekanizma nuk arrijnë t'i përmbushin detyrat themelore. Faktorët si gjendja politike dhe ndryshimet në përfaqësim pas zgjedhjeve vazhdojnë të ndikojnë në masë të konsiderueshme në funksionimin e këtyre mekanizmave.¹²¹ Përveç kësaj, ndonëse gjatë periudhës për të cilën raportohet u shënuar një

Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe në Ministrinë e Financave, si dhe një gran të Kosovës në Ministrinë e Drejtësisë.

¹¹⁷ Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, 20 shkurt 2008, dhe Rregullorja nr. 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim, 27 gusht 2010.

¹¹⁸ KK janë themeluar në çdo komunë të Kosovës duke përfshirë katër komunat në veri. ZKKK janë themeluar në të gjitha komunat e Kosovës, përveç komunave veriore, ndonëse disa ZKKK nuk kanë numër të mjaftueshëm të punonjësve.

¹¹⁹ ZKKKK nuk është emëruar në komunën e Gračanica/Gračanicës sepse asnjë pjesëtar i komunitetit në pakicë numerike nivel komunal nuk është zgjedhur në kuvendin e komunës.

¹²⁰ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) zhvilloi aktet nënligjore dhe dokumentet udhëzuese të politikave për të mbështetur funksionimin e këtyre katër mekanizmave. Ato janë si në vijim: Udhëzimi administrativ nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencave të komisioneve të përhershme në komunë, 7 korrik 2014; UA nr. 2014/01 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna, 28 janar 2014; 'termat e referencës për nënkryetarin për komunitete' miratuar nga MAPL më 21 nëntor 2014, si dhe 'termat e referencës për zëvendëskryesuesin e kuvendit të komunës për komunitete që pritet të miratohet zyrtarisht nga MAPL-ja deri në dhjetor të vitit 2015.

¹²¹ Për shembull, ndonëse monitorimi i bërë nga OSBE-ja shënoi se deri në maj 2014 gati një e treta e KK kishin nxjerrë rekomandime për çështje të veçanta që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve, kjo përqindje u shtua gati në gjysmën e KK-ve deri në nëntor të vitit 2014, por ende ishte shumë larg nga nëntë KK që e kishin bërë këtë në mandatin para zgjedhjeve komunale; megjithatë, nuk është shënuar përparim i rëndësishëm përkitazi me numrin e KK që raportojnë në Kuvendin e komunës për zbatimin e projekteve për komunitetet e që vetëm katër KK e kanë bërë në mënyrë efektive në vitin 2014. Ngjashëm, nga monitorimi është vlerësuar se 90 për qind e ZKKK kanë vendosur raport me të gjitha komunitetet, por vetëm gjysma e tyre kanë kryer vlerësimin e nevojave dhe edhe më pak kanë monitoruar politikat përkitazi me të drejtat e komuniteteve në gjysmën e dytë të vitit 2014 (nëntë) në krahasim me gjysmën e parë të vitit 2014 (13): një numër më i madh i ZKKK kryen këto dy detyra në periudhën para zgjedhjeve komunale në vitin 2013. Ajo çka nevojitet është ndërtimi i kapaciteteve për të forcuar mekanizmat, posaçërisht pas zgjedhjeve kur anëtarësia/personeli priret të pësojë ndryshim. Për më shumë hollësi, ju lutem shihni raportin e OSBE-së:

rritje në emërimin e pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian pas zgjedhjeve komunale që u mbajtën në vitin 2013¹²², monitorimi i ndërmarrë nga OSBE-së identifikoi si shqetësim kontaktet e dobëta mes komunave dhe komuniteteve në pakicë numerike në nivel komunal¹²³ si dhe komuniteteve rurale, duke nënvizuar kështu rëndësinë e vazhdueshme të rekomandimit nga raporti i fundit për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve se vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përfaqësimit të këtyre komuniteteve. Përfaqësimi i grave nga komunitetet mbetet brengë: vetëm 80 anëtarë të KK-ve janë gra nga gjithsej 266 anëtarë të KK-ve të caktuar në tërë Kosovën; vetëm 45 punonjëse janë gra nga 154 zyrtarë komunalë të angazhuar në ZKKK-të në Kosovë; dhe vetëm një NKK nga 13 të emëruar dhe një ZKKKK nga 10 të tillë janë gra.

Përderisa MAPL-ja po diskutonte për përfundimin e procesit të decentralizimit në një raport të botuar më 2012, siç përcaktohej me Ligjin për vetëqeverisjen lokale të vitit 2008¹²⁴, marrëveshja politike çoi në një zhvillim të rëndësishëm në zgjedhjet komunale në nëntor të vitit 2013 që siguroi përfshirjen e katër komunave veriore të Kosovës (Zvečan/Zveçan, Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovica/Mitrovicë Veriore) në kuadër të strukturave qeveritare të Kosovës dhe që të gjitha po vazhdojnë të punojnë në harmonizimin e sistemeve të tyre, personelit dhe administratës komunale në përputhje me komunat e tjera të Kosovës. Gjithashtu, përfaqësuesit e serbëve të Kosovës nga komunat veriore tani po marrin pjesë në strukturat qeveritare në nivel qendror në disa mënyra, si anëtarë të KKK dhe Kuvendit të Kosovës.

Sfidat e mbetura

Ajo çka mungoi më së shumti gjatë periudhës për të cilën raportohet ishte çfarëdo nisme me rëndësi për të ndryshuar kushtetutën, siç u zotua ish-kryeministri, për të pasqyruar ndarjen e ulëseve të garantuara në Kuvendin e Kosovës për komunitetin malazez dhe kroat të Kosovës pas përfshirjes dhe njohjes së tyre në Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe përfshirjes së tyre në përbërje të KKK.¹²⁵ Roli i KKK në shqyrtimin dhe komentimin e nismave legjislative dhe në promovimin e mirëkuptimit dhe tolerancës mes komuniteteve mbetet i kufizuar. Gratë dhe komunitetet numerikisht më të vogla vazhdojnë të mbesin të nënpërfaqësuar në katër mekanizmat për komunitetet në nivel të qeverisë komunale (KK, ZKKK, NKK dhe ZKKKK) dhe monitorimi i kryer nga OSBE-ka tregon se përkrahja politike për mekanizmat në fjalë shpesh mbetet e ulët dhe nuk u jepet

Vlerësim i mekanizmave të nivelit lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve, qershor 2014, <http://www.osce.org/kosovo/120343> (qasur më 28 tetor 2015).

¹²² Një ashkali i Kosovës dhe një rom i Kosovës u emëruan si NKK në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, përkatësisht Gračanica/Gračanicë që pasqyron një rritje nga asnjë përfaqësues nga këto tre komunitete në periudhën e mëparshme legjislative, kurse një egjiptian i Kosovës dhe një ashkali i Kosovës u zgjedhën ZKKKK në Pejë/Peć, përkatësisht në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, duke shënuar rënie nga tre pozitat që i takonin komunitetit egjiptian të Kosovës në periudhën e mëparshme, pjesërisht si pasojë e asaj që MAPL-ja sfidoi vendimet për të themeluar pozitën kur kjo nuk përcaktohej me ligj.

¹²³ Përderisa KK ofrojnë një mundësi për pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunë, komunitetet më të vogla mbesin të nënpërfaqësuar në shumë KK. Përfaqësuesit e romëve të Kosovës nuk janë të pranishëm në pesë KK ku përcaktohet përfaqësimi i tyre, ashkalitë e Kosovë në dhjetë KK, egjiptianët e Kosovës në 12, goranët e Kosovës në 14, turqit e Kosovës në 20 dhe përfaqësuesit e boshnjakëve të Kosovës nuk janë të pranishëm në 21 KK.

¹²⁴ MAPL "Raport i progresit për zbatimin e decentralizimit në Kosovë, botuar në gusht të vitit 2012, <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/3cf94334-1267-4e0e-ae69-6dbb77848a1a/PROGRESS-REPORT-ON-IMPLEMENTATION-OF-DECENTRALIZAT.aspx>. (qasur më 28 tetor 2015).

¹²⁵ Neni 12.6 për përbërjen e KKK, Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, fusnota 3 më lart.

prioritet nga udhëheqësia komunale. Mekanizmave shpesh u mungojnë burimet e nevojshme për të pasur komunikim dhe kontakt të mirëfilltë me komunitetet. Nuk janë ndërmarrë përpjekje të targetuara nga Institucionet e Kosovës për të siguruar më shumë pronësi dhe konsultim të komuniteteve në nismat legislative dhe të politikave që i prekin ato në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Rekomandimi 12

Të shtohen përpjekjet për të siguruar qasje të barabartë për personat të cilët i përkasin komuniteteve pakicë në të drejtat socio-ekonomike siç janë shërbimet shëndetësore, punësimi dhe mundësi afariste duke përfshirë procesin në vazhdim e sipër të privatizimit.

Gjendja e tanishme

Të drejtat socio-ekonomike dhe qasja në shërbime

Qasja në shërbime, duke përfshirë mundësitë e punësimit, shërbimet publike dhe ato shëndetësore, mbetet sfidë e madhe për komunitetet në gjithë Kosovën, sidomos komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës.¹²⁶ Institucionet e Kosovës kanë shënuar pak përparim në këtë fushë që thekson nevojën për veprim të përbashkët në ofrim të qasjes së barabartë në të drejta socio-ekonomike, që mbulon edhe mundësitë e punësimit por edhe heqjen e pengesave ndaj vetë-punësimit, duke përfshirë punët në bujqësi¹²⁷. Raporti i OSBE-së i publikuar më 2013¹²⁸ vlerësoi se dispozitat kryesore të Ligjit për Shërbimin Civil¹²⁹ nuk janë duke u zbatuar plotësisht. Në dhjetor të vitit 2013, ZÇK-ja botoi një raport mbi qasjen në punësim të komuniteteve joshqiptare¹³⁰, që përmbante dymbëdhjetë rekomandime, përfshirë ato që synonin komunitetin rom, komunitetin ashkali, komunitetin goran dhe komunitetin egjiptian të Kosovës, angazhimin me baraspeshë gjinore dhe masat ndëshkuese për institucionet që nuk performojnë mirë në punësimin e komuniteteve. Derisa bllokada politike¹³¹ kishte penguar miratimin formal të këtyre rekomandimeve, ZÇK-ja kishte

¹²⁶ Vlerësimet e OSBE-së të publikuara më 2013 kanë vënë në pah çështje lidhur me nënpërfaqësimin në shërbimin civil që kryesisht prekin komunitetin rom, komunitetin ashkali dhe komunitetin egjiptian të Kosovës për shkak të mungesës së kualifikimeve arsimore, por edhe të komunitetit serb të Kosovës dhe atij goran të Kosovës kryesisht për shkak të mosnjohjes së certifikatave ose diplomave të lëshuara nga institucionet që ndjekin kurrikulën e Serbisë. Shih raportin e OSBE-së *Përfaqësimi i komuniteteve në Shërbimin Civil të Kosovës, shkurt 2013* <http://www.osce.org/kosovo/99601> (qasur më 28 tetor 2015).

¹²⁷ Përkritazi me qasjen në tokën bujqësore, uzurpimi i paligjshëm i tokës mbetet problem, dhe kryesisht prek komunitetin serb të Kosovës dhe i kufizon mundësitë e tyre ekonomike: OSBE ka regjistruar 12 raste të tilla gjatë periudhës për të cilën raportohet.

¹²⁸ Shih raportin e OSBE-së, *fusnota Error! Bookmark not defined. më lart.*

¹²⁹ Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, 26 qershor 2010. Ligji parasheh që se paku 10 për qind e forcës punëtore duhet të jetë nga anëtarët e komuniteteve në nivel qendror dhe se, në nivel lokal, ky përfaqësim duhet të jetë në proporcion me përbërjen demografike të çdo komune. Korniza ligjore kërkon nga institucionet punëdhënëse të implementojnë një seri masash pozitive që synojnë shtimin e punësimit dhe promovimin e anëtarëve të komuniteteve.

¹³⁰ Raporti i ZÇK-së (http://www.zck-ks.net/repository/docs/Assessment_on_Employment.pdf, (qasur më 28 tetor 2015) ka konkluduar që përfaqësimi i komuniteteve ka qenë 7.7 për qind në institucionet e nivelit qendror dhe lokal, ku pjesëtarët e komunitetit ashkali, egjiptian, goran e rom të Kosovës janë relativisht të nën-përfaqësuar, ndërsa përfaqësimi i komunitetit boshnjak, serb e turk të Kosovës është më afër niveleve të tyre përkatëse të regjistrimit të popullsisë. Raporti thekson që një prej probleme primare në punësimin e komuniteteve ka të bëjë me mos-njohjen e kualifikimeve arsimore të kandidatëve.

¹³¹ Zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 8 qershor 2014 ishin pasuar me gjashtë muaj bllokada politike deri në zgjedhjen e Isa Mustafës si Kryeministër më 9 dhjetor 2014.

implementuar së paku disa prej tyre, duke udhëhequr një program praktikantësh për disa komunitete.¹³²

Një vlerësimi i qasjes së komuniteteve në shërbime u krye nga OSBE-së gjatë periudhës janar 2014 – maj 2015: pas konsultimeve me zyrtarë komunalë dhe përfaqësues të komuniteteve në nivel lokal, dhe nga ai u konkludua se komunitetet kishin hasur në probleme në qasjen e tyre në shërbime publike në 23 nga 38 komuna. Problemi më i shpeshtë i raportuar tek monitoruesit e OSBE-së në terren ka qenë mosfunksionimi i ndriçimit publik në lagjet joshqiptare, i lidhur ky me brengën e sigurisë.¹³³ Vlerësimi gjeti edhe raportime të ndërprerjeve në furnizim me ujë dhe probleme me sisteme të kanalizimi në rreth një të tretën e komunave. Megjithatë, kjo çështje nuk i kishte prekur komunitetet në mënyrë disproporcionale. Në komunat e veriut, faturat e lëshuara nga ndërmarrjet publike të udhëhequra nga Serbia vazhdojnë të mos njihen nga shqiptarët e Kosovës, duke rezultuar kështu në dështim të pagesës dhe shkyçje nga shërbimet.¹³⁴

Që prej publikimit të Raportit të fundit për Vlerësimin e të drejtave të komuniteteve, komuniteti serb i Kosovës ka vazhduar të preferojë institucionet shëndetësore të udhëhequra nga Serbia¹³⁵, ndonëse artikujt medicinalë dhe barnat në sistemin e udhëhequr nga Serbia mbeten problem, pasi që institucionet e Kosovës kanë lëshuar licencë vetëm për një farmaci të licencuar të Serbisë në Kosovë.¹³⁶ Mungesa e farmacive të licencuara dhe përzgjedhja e barnave në listën e qeverisë së Kosovës për barnat e licencuara mund të kufizojnë furnizimin e barnave në institucionet mjekësore që shfrytëzohen nga serbët e Kosovës.¹³⁷

Krahas komuniteteve më të vogla, më të izoluara, përfshirë edhe komunitetin e të kthyerve në rajonin e Pejës/Peć dhe komunën e Ferizajt/Uroševac, komuniteti shqiptar në komunat veriore gjithashtu është prekur nga shkurtimi i linjave të transportimit humanitar me autobusë gjatë periudhës prej verës së vitit 2014 deri në qershor të vitit 2015: transportimi i posaçëm për komunitete, sidomos aty ku nuk ka shërbime komerciale, mbetet çështje kyçe në qasjen e

¹³² Në shtator të vitit 2014, ZÇK-ja kishte lansuar një program praktikantësh të financuar nga Norvegjia, që mbështeti vendosjen e 100 praktikantëve jo-shqiptarë në institucione të ndryshme qendrore e lokale për një periudhë gjashtë-mujore, ndërsa ZÇK-ja planifikon të përsërisë këtë iniciativë. Megjithatë, pasi që shumica e këtyre praktikantëve kanë diploma nga Universitetin në Mitrovica/Mitrovicë veriore, çfarëdo punësimi në të ardhmen në shërbimin publik do të varet nga njohja apo vërtetimi i diplomave të tyre.

¹³³ Problemet me ndriçimin rrugor gjatë janarit 2014 – majit 2015 janë raportuar tek monitoruesit e OSBE-së në 13 komuna dhe prej tyre 10 kanë prekur komunitetet joshqiptare (komunitetin rom, ashkali, egjiptian në gjashtë komuna dhe komunitetin serb në katër komuna). Për shembull në Skënderaj/Srbica, palët e kontaktuara theksonin që serbët në Banja/Banjë nuk ndjehen të sigurt që të shëtisin në fshat kur është errësirë, për shkak të mungesës së ndriçimit publik; brenga të ngjashme të sigurisë janë përmendur edhe në Fushë Kosovë/Kosovo Polje sa i përket fëmijëve që kthehen nga shkolla gjatë dimrit.

¹³⁴ Shumë shqiptarë në këto komuna theksojnë që mos-pagesa e tyre ka pasur të bëjë me paqartësinë në lidhje me menaxhimin e furnizimit të energjisë elektrike, temë kjo e Dialogut të Brukselit nga i cili pritet të gjejë zgjidhje për çështjet në sektorin e energjisë; shih “Konkludimet e Lehtësuesit të BE-së mbi implementimin e Marrëveshjes së Energjisë 2013”, 25 gusht 2015; për më shumë hollësi: <http://www.kim.gov.rs/eng/pregovaracki-proces.php>. (qasur më 28 tetor 2015).

¹³⁵ Nëntëmbëdhjetë komuna të Kosovës kanë së paku një barnatore të licencuar nga sistemi shëndetësor i udhëhequr nga Beogradi.

¹³⁶ Vetëm komuna Istog/Istok ka farmaci të licencuar nga Beogradi dhe nga Prishtina/Priština. Farmacia e licencuar në Beograd e vendosur në Leposavić/Leposaviq ka aplikuar për licencë të Kosovës më 10 mars 2015, por nuk ka marrë ndonjë përgjigje apo informatë tjetër sa i përket progresit të aplikimit.

¹³⁷ Problemet janë raportuar në Pejë/Peć, Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan/Zveçan, Mitrovica/Mitrovicë Veriore, Kamenicë/Kamenica, Ranilug/Ranillug, Novo Brdo/Novobërdë, Lipjan/Lipljan, Gračanica/Graçanicë, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Obiliq/Obilić.

komuniteteve në disa shërbime themelore.¹³⁸ Ndonëse ura kryesore që lidh Mitrovicën veriore me Mitrovicën jugore mbetet e bllokuar për trafikun rrugor, dhe qarkullimi në trafik kufizohet në hyrjen lindore për në qendër të Mitrovicës veriore, është arritur progres i dukshëm në fushën e lirisë së lëvizjes gjatë periudhës për të cilën raportohet. Kufizimet në liri të lëvizjes për shkak të bllokimeve të rrugëve në Kosovën veriore, gjë që kishte prekur negativisht udhëtimin e disa komuniteteve në qendrat urbane në vitin 2012 dhe 2013, tani janë larguar dhe nuk janë më problem.

Komuniteti rom, komuniteti ashkali dhe komuniteti egjiptian i Kosovës

Institucionet e Kosovës kanë dështuar në arritjen e zbatimit të bashkërenduar dhe sistematik të *Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë, 2009-2015*. Në janar të vitit 2014, u bë një përpjekje nga Komiteti Drejtues Ndërmnistror, atëherë i udhëhequr nga Ministria për Integrimin Evropian, ndërsa tash udhëhequr nga Zëvendëskryeministri, për të mbikëqyrur dhe bashkërenduar veprimet prioritare.¹³⁹ Megjithatë, mangësitë në komunikim e bashkërendim ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre lokale kanë vazhduar të jenë problematike, duke u zgjeruar tutje edhe me mungesën e vullnetit politik. Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë (ZQM), kryesuesja e Grupit Punues Teknik përgjegjës për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e strategjisë së lartpërmendur, ka dështuar në grumbullimin e të dhënave adekuate, sigurimin e raporteve të sakta, e edhe në përfshirjen kuptimplote të pjesëtarëve të të tri komuniteteve në zbatim apo raportim. Në maj të vitit 2015, ZQM-ja filloi hapat në zhvillim të strategjisë së re të integrimin për periudhën 2016-2020, me konsultime të kufizuara sistematike deri më sot. Me përjashtim të disa përpjekjeve sporadike¹⁴⁰ nga disa institucione për të përmirësuar integrimin e të tri komuniteteve, nuk është arritur ndonjë progres i dukshëm. Me gjasë, përparimi më i madh është arritur në nivel lokal, pasi që disa komuna kanë hartuar dhe miratuar Planet Lokale të Veprimit (PLV-të) për integrimin e të tri komuniteteve, duke përfshirë këtu edhe shoqërinë civile përkatëse.¹⁴¹

PZH-të nga komuniteti rom, komuniteti ashkali dhe komuniteti egjiptian i Kosovës janë prekur në të kaluarën për shkak të banimit të tyre në kampe të përkohshme të vendosura në tokë të kontaminuar me plumb: këto kampe janë mbyllur dhe shqetësimet për nivel të lartë të

¹³⁸ Që prej fundit të qershorit 2015, katër linja që përfundonin në Mitrovicë të Jugut/Mitrovica dhe/ose Zvečan/Zvečan nuk funksiononin më. Për më shumë, shih raportin e OSBE-së për *Transportimin special për komunitetet në Kosovë*, mars 2015, <http://www.osce.org/kosovo/143476> (qasur më 28 tetor 2015).

¹³⁹ ‘Përcaktimi i veprimeve prioritare të parapara në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian’, shkurt 2014, Ministria e Integrimin Evropian, i cili përcakton masat dhe aktivitetet me prioritet, të cilat rrjedhin nga *Strategjia dhe Plani i Veprimit për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë, 2009-2015*, kryesisht në sektorët e arsimit, punësimit, shëndetit dhe mirëqenies sociale, si dhe banimit, si dhe që parasheh zbatimin e tyre deri në fund të vitit 2015.

¹⁴⁰ Për shembull, promovimi nga MASHT-i i mësimdhënies në gjuhën rome, siç theksohet më lart tek Rekomandimi 4.

¹⁴¹ Deri në fund të qershorit 2015, PLV-të janë miratuar në dhjetë komuna (Prizren, Obiliq/Obilić, Shtime/Štimlje, Suharekë/Suva Reka, Rahovec/Orahovac, Ferizaj/Uroševac, Vuštrri/Vučitrn, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok dhe Klinë/Klina). Përveç këtyre, tri komuna kanë filluar hartimin e PLV-ve gjatë periudhës së raportimit (Gračanica/Graçanicë, Fushë-Kosovë/Kosovo Polje dhe Deçan/Dečani), ndërsa tri të tjera kanë hartuar dhe finalizuar PLV-në dhe mbetet të miratohen ato deri në fund të qershorit 2015 (Mitrovicë jugore, Kamenicë/Kamenica dhe Gjilan/Gnjilane). Dy PLV kanë skaduar gjatë periudhës së raportimit (Lipjan/Lipljan dhe Novo Brdo/Novobërdë); është tashmë e paqartë nëse mund të priten plane të reja.

plumbit në gjak tani janë qetësuar. Për vendbanimin “Mëhalla Rome” në Mitrovicë jugore, ku janë vendosur shumica e personave të zhvendosur nga kampet e kontaminuar me plumb në Mitrovicën veriore dhe Zvečan/Zveçan, nga monitorimi i kryer nga OSBE shihet që përgjithësisht ofrohet kujdes dhe përkrahje adekuate e specializuar shëndetësore (ndonëse ka ca brenga lidhur me ofrimin e vazhdueshëm të tij në të ardhmen).¹⁴²

Institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë disa masa në lidhje me rritjen e regjistrimit civil të të tri komuniteteve, si dhe në zvogëlimin e numrit të personave të paregjistruar, që përballen me vështirësi në qasje në shërbime. Në vitin 2015, MAPL dhe MPB kishin nxjerrë udhëzime për komunat¹⁴³, duke përsëritur veprimin e ngjashëm të bërë gjatë viteve të kaluara, për t’i inkurajuar ato që të kenë muaj të regjistrimit pa pagesë për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, dhe lirim nga tarifat e vonesës në regjistrim për një periudhë një-vjeçare respektivisht. Më 14 nëntor 2014, Agjencia e Regjistrimit në MPB ka krijuar edhe një grup pune për të identifikuar personat e paregjistruar në Kosovë.

Megjithatë, shumë pak është bërë nga institucionet e Kosovës në adresim të nivelit të lartë të analfabetizimit tek komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës,¹⁴⁴ ndërsa përpjekjet për të promovuar mundësitë e punësimit të qëndrueshëm për komunitete gjithashtu janë kufizuar në punësime sezonale dhe trajnime për fillim biznesi për disa pjesëtarë të riatdhesuar të komuniteteve. Komunat Ferizaj/Uroševac dhe Rahovec/Orahovac kanë ndihmuar një numër pjesëtarësh të të tri komuniteteve me iniciativa specifike¹⁴⁵, por komunat tjera kanë ofruar mundësi të kufizuara për punësim të përkohshëm, zakonisht në shërbime të mirëmbajtjes¹⁴⁶.

Vendosja e kritereve më strikte për përfitim të ndihmave sociale nga familjet¹⁴⁷, që përshin edhe përkufizimin e ngushtë të “familjeve që jetojnë në një ekonomi familjare”, është vërtetuar si e pafavorshme për familjet romë, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës, të cilat shpesh jetojnë në familje me shumë breza, si dhe ka çuar drejt heqjes së shumë pjesëtarëve të komuniteteve nga listat e përfituesve. Vlerësimet e OSBE-së të kryera mes janarit të vitit 2014 dhe majit të vitit 2015 kanë treguar që vlerësimet e qendrave komunale për mirëqenie

¹⁴² Analizat e gjakut të kryera në fillim të vitit 2015 kanë zbuluar vetëm një rast me nivel të lartë të plumbit me mbi 45mg/dL. Megjithatë, fondet e pakësuara të donatorëve nënkupton që trajtimi adekuat mjekësor nuk është më në dispozicion ndërkohë që ka shumë persona ende me nivele më të larta se niveli prej 10mg/dL.

¹⁴³ Përkatësisht letra e MAPL-së e 20 janarit 2015 për komunat dhe shkresa e Agjencisë së Regjistrimit Civil e lëshuar më 26 mars 2014, ref. 02/426.

¹⁴⁴ Një raport i fundit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregon që 72.8 për qind e grave të reja nga tri komunitetet, në moshën prej 15 deri në 24 vjeç, janë në gjendje të lexojnë deklaratime të shkurtra të thjeshta për jetën e përditshme, derisa 86.5 për qind e burrave të rinj në grupmoshën e njëjtë mund ta bëjnë këtë. “Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë 2013-2014, Gjetjet kryesore, tetor 2014, Agjencia e Statistikave të Kosovës, mund të gjendet tek: https://ask.rks-gov.net/ENG/images/files/MICS20Key20Findings20Report20-20Roma20-20English_20150525.pdf.

¹⁴⁵ Komuna Ferizaj/Uroševac ka punësuar 77 ashkali në ndërmarrjen publike të grumbullimit të mbeturinave. Komuna Rahovec/Orahovac ka filluar një projekt të bashkëfinancuar nga BE-ja, duke ofruar aftësim profesional për nëntë pjesëtarë të të tri komuniteteve (përfshirë pesë gra), duke iu ndihmuar atyre në themelimin të bizneseve.

¹⁴⁶ Si shembull, në Klinë/Klina tetë egjiptianë dhe romë kanë përfutur mëditje për një periudhë dy-javore për grumbullimin e mbeturinave në zona publike, përmes iniciativës “Të pastrojmë Klinën” (“Let’s clean Klinë/Klina”).

¹⁴⁷ Ligji nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Asistencës Sociale në Kosovë, 13 qershor 2012.

sociale dallojnë nga komuna në komunë, ku Prishtina/Priština, Gjakova/Đakovica dhe Mitrovica jugore janë vlerësuar të kenë numrin më të lartë të përfituesve të prekur nga kjo.¹⁴⁸ Në 21 komuna, respondentët në vlerësimin e OSBE-së nga qendrat për mirëqenie sociale, komuna dhe komunitete kanë raportuar për ankesa kundër vendimeve negative të parashtruara nga ata që kishin humbur të drejtën e tyre në ndihma sociale për shkak të kritereve të reja: Reagimi i respondentëve bënte të ditur që ndonëse një numër i vogël i këtyre ankesave kishin përfunduar me rivendosje të ndihmës sociale, shumica kanë qenë të pasuksesshme.

Përfundimisht, intervistat e zhvilluara nga OSBE me zyrtarë komunalë dhe përfaqësues të komuniteteve vlerësuan ndikimin mbi komunitetet pakicë numerike në nivel komunal të valës së migrimëve 2014–2015 nga Kosova drejt vendeve të Bashkimit Evropian¹⁴⁹. Në disa komuna, përfaqësuesit e komuniteteve shprehën brengën për migrimin e shumë anëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës duke e identifikuar varfërinë, mungesën e mirëqenies sociale, sigurimin shëndetësor dhe mundësitë për punësim si arsye primare për këtë¹⁵⁰.

Sfidat e mbetura

Qasje e komuniteteve në punësim vazhdon të pengohet nga zbatimit jo i plotë i Ligjit për Shërbimin Civil¹⁵¹, mungesa e progresit në njohjen e diplomave, si dhe mungesa e politikave të mjaftueshme të punësimit të fokusuar tek të cenueshmit. Barrierat administrative për licencim të barnave dhe farmacive vazhdojnë të pengojnë qasjen e disa komuniteteve në kujdes shëndetësor. Personat e mbetur pa regjistruar në regjistrin civil vazhdojnë të përballen me vështirësi të mëdha për qasje në një mori të drejtash. Diskriminimi i tërthortë ndaj komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës kur merren vendime për kualifikimin për ndihma sociale mbetet brengë potenciale.

Institucionet e nivelit qendror duhet të rishikojnë në mënyrë kritike strukturat përgjegjëse për Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë, 2009–2015, për të siguruar inkorporimin e përmirësimeve substanciale në politikat e integritimit pas vitit 2015, duke përfshirë edhe në strukturat menaxhuese dhe bashkërenduese përgjegjëse për strategjinë, si dhe përfshirjen e sinqertë të të tri komuniteteve në planifikim dhe implementim. Duke marrë parasysh përgjegjësitë në një numër të madh fushash ndër-qeveritare (përfshirë të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijës, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, qeverisjen e mirë, angazhimi i shoqërisë civile, etj.), si dhe performancën e dobët deri më sot, kapacitetet e ZQM-së për të performuar në mënyrë efektive në lidhje me politikat e integritimit për tri komunitetet kanë nevojë për rishqyrtim serioz.

¹⁴⁸ Vlerësimet nga komunitetet dhe burimet lokale janë që në Prishtinë/Priština, afërsisht 400 familje janë prekur, në Gjakovë/Đakovica janë 300 persona, ndërsa në Mitrovicë jugore 400 të tillë.

¹⁴⁹ Raport i brendshëm i OSBE-së, *Vlerësim i migrimit të parregullt*, 29 prill 2015.

¹⁵⁰ Periudha e raportimit për këtë vlerësim ishte 1 korriku 2014 – 28 shkurt 2015. Derisa ky fenomen prekte të gjitha komunitetet e Kosovës, në së paku 14 komuna, komunitetet në pakicë numerike në nivel komunal kishin më shumë raste të migrimit sesa komuniteti shumicë për shkak të kushteve të tyre edhe më të vështira të jetesës. Për saktësi, në 13 komuna, respondentët nga komunitetet e intervistuar raportonin që më shumë migrues ishin nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës sesa nga komunitetet shumicë, për shkak të kushteve të tyre të dobëta të jetesës, si dhe mungesës së përkrahjes sociale.

¹⁵¹ *Më lart*, fusnota 136.

1. INSTITUCIONET PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Rekomandimi 6

T'i sigurohen Institucionit të Avokatit të Popullit resurse adekuate njerëzore dhe financiare, duke përfshirë ato në lidhje me aktivitetet përkatëse të vetëdijesimit dhe trajnimit, si dhe të zbatohen përkatësisht rekomandimet e Avokatit të Popullit në nivel qendror dhe lokal.

Gjendja e tanishme

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka pranuar gjithsej 2,224 ankesa në vitin 2014¹⁵², pra një rritje prej 10 për qind nga viti i kaluar. Shumica e këtyre rasteve, 75 për qind, ishin të papranueshme, pasi që ankesat ishin ende në fazë të shqyrtimit administrativ, ose nuk kishin shteruar të gjitha mjetet përkatëse juridike.¹⁵³ Në kuptimin e reagimit të institucioneve të Kosovës ndaj IAP-së, më pak se 35 për qind të kërkesave dhe rekomandimeve janë zbatuar më 2014¹⁵⁴. Përkundër kësaj rritjeje të kërkesave dhe reagimeve të kufizuara institucionale, IAP-së i janë dhënë edhe më shumë përgjegjësi përmes Ligjit të vitit 2015 për Avokatin e Popullit, i cili krijon një mekanizëm parandalues për parandalimin e torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese, ndërsa Ligji për Mbrojtjen kundër Diskriminimit i jep IPA-së rolin e organit të barazisë.¹⁵⁵ IAP-ja funksionon me një zyrë qendrore dhe tetë të tilla rajonale, duke u ballafaquar me sfida si rezultat i hapësirave joadekuate për punë, gjë që ndikon tek rekrutimi i personelit me aftësi të kufizuara, si dhe hapësirat e mirëfillta për intervistimin e ankuesve.¹⁵⁶

Monitorimi i kryer nga OSBE-ja ka identifikuar probleme të tjera, duke përfshirë dobësitë organizative të IAP-së: strukturat joadekuate të menaxhimit të brendshëm dhe të komunikimit; mungesa e procedurave të planifikimit vjetor; komunikimi joadekuat apo komunikimi joadekuat me komunitetin nga zyrat rajonale¹⁵⁷, mungesa e bashkëpunimit me shoqërinë civile. Komunikimi i jashtëm me komunitetet mbetet sfidë e veçantë.¹⁵⁸ Gjitha këto probleme vazhdojnë të kufizojnë kapacitetin e IAP-së në adresim efektiv të nevojave të personave të cenueshëm dhe të marginalizuar. Mandati i Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij ka skaduar në qershor të vitit 2014, respektivisht në tetor të vitit 2014. Në periudhën e ndërmjetme, IAP-ja është udhëhequr nga Avokati i Popullit i emëruar përkohësisht, i

¹⁵² Shih IAP, Raporti vjetor 2014 http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/RAPORTI_2014_-_anglisht_21841.pdf (qasur më 28 tetor 2015).

¹⁵³ Faqe 23, *më lart*, fusnota 162.

¹⁵⁴ Faqet 93-100, *më lart* fusnota 162.

¹⁵⁵ Shih neni 17, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, si dhe neni 12, Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi, 28 maj 2015.

¹⁵⁶ Aktualisht, zyra qendrore e IAP-së është shtëpi private e marrë me qira. Zyrat rajonale të IAP-së janë të vendosura në Prizren, Pejë/Peć, Gjakovë/Đakovica Gjilan/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac Štrpce/Shtërpce, Mitrovicë jugore dhe Mitrovicë veriore.

¹⁵⁷ “Ditët e hapura” që organizohen nga IAP-ja ofrojnë mundësi të përmuajshme për takime me Avokatin e Popullit apo zëvendësit e tij në komuna të ndryshme. Përkundër raporteve të IAP-së që këto gjëra janë mjaft të publikuara, monitorimi i kryer nga OSBE-ja tregon që këto aktivitete nuk janë fort të suksesshme në kuptimin e përafrimit me një numër të mjaftueshëm të njerëzve. Përveç “Ditëve të Hapura”, shumica e iniciativave të tilla përafruese kufizohen tek pjesëmarrja e IAP-së në aktivitete të organizuara nga shoqëria civile apo organizatat ndërkombëtare (për shembull, IAP-ja ka marrë pjesë në aktivitete të përkrahura nga UNICEF-i apo shoqëria civile).

¹⁵⁸ Për shembull, Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit në Gračanica/Graçanicë nuk kishte personel që flet gjuhën shqipe, derisa Zyra Rajonale në Prizren nuk ka kapacitete komunikimi në gjuhën serbe, boshnjake apo turke.

mbështetur nga pesë zëvendës përmes një mandati teknik, pa mundësinë e rizgjedhjes.¹⁵⁹ Procedura e rekrutimit të Avokatit të Popullit ka vazhduar që prej shpalljes së konkursit të parë në janar të vitit 2014, pasuar me dy përpjekje të pasuksesshme të Kuvendit të Kosovës në zgjedhjen e një individi, para emërimit të Z. Hilmi Jashari në korrik të vitit 2015.¹⁶⁰

Sfidat e mbetura

Ndonëse dhënia e përgjegjësive të reja është pozitive për IAP-në, sfidat praktike mund të përkeqësohen më tutje nga ngarkesa e rritur e punës në zyrë. Siç është thënë nga Avokati i Popullit në një numër rastesh, edhe pse IAP-ja ka mjete të mjaftueshme buxhetore për punët e rregullta, me marrjen e përgjegjësive dhe funksioneve të reja shtesë, rritja e numrit të stafit dhe e kapaciteteve si për stafin ekzistues edhe për atë të ri¹⁶¹, por edhe menaxhimi dhe komunikimi i brendshëm më i mirë është i domosdoshëm. Pjesërisht si rezultat i problemeve me hapësirat e zyrave dhe mundësive të kufizuara për diskutime me ankesues, ka pasur një numër tejet të lartë të ankesave të papranueshme të dorëzuara gjatë vitit 2014, afërsisht 75 për qind të numrit të përgjithshëm të rasteve të pranuar.¹⁶²

Rekomandimi 7

Të merren të gjithë hapat e domosdoshëm për ta bërë legjislacionin kundër diskriminimit më të zbatueshëm, si dhe të sigurohet që autoritetet komunale të jenë të trajnuar e të udhëzuara në mënyrë të përshtatshme për t'u marrë me ankesat përkatëse; të themelohet një sistem gjithëpërfshirës në përputhje me standardet përkatëse për mbrojtjen e të dhënave, të mblidhen informata të kategorizuara mbi ankesat në lidhje me diskriminimin, si dhe të mundësohet zhvillimi i masave të fokusuara në promovim të barazisë së plotë dhe efektive të personave që i përkasin komuniteteve pakicë ...

Gjendja e tanishme

Ligji i vitit 2004 kundër diskriminimit¹⁶³ është vlerësuar si gjithëpërfshirës në kuptimin e përkufizimit të të gjitha formave të diskriminimit¹⁶⁴ si dhe bazave për mbrojtjen dhe promovimin e barazisë, trajtimit të barabartë dhe tolerancës. Megjithatë, është vlerësuar si i dobët në përshkrimin e mekanizmave të zbatimit, duke e bërë implementimin e tij të dobët. Gjatë periudhës së raportimit, Zyra e Kryeministrit ka arritur përparim të mëtejshëm, duke zhvilluar një pako të ligjeve për të drejtat e njeriut, duke përfshirë këtu Ligjin për Avokatin e Popullit, Ligjin e rishikuar të mbrojtjes nga diskriminimi,¹⁶⁵ si dhe Ligjin për barazinë gjinore¹⁶⁶, të cilët janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 28 maj 2015.

¹⁵⁹ Një prej zëvendësve të emëruar, Z. Bogoljub Staletoviq, nga komuniteti serb i Kosovës, është pezulluar në qershor të vitit 2014, si dhe nuk është zëvendësuar më gjatë periudhës së raportimit; mandati i tij ka skaduar në tetor të vitit 2014.

¹⁶⁰ Përpjekjet e dështuara për zgjedhje janë bërë gjatë marsit të vitit 2014 si dhe në prill të vitit 2015. Më 2 korrik 2015, Z. Hilmi Jashari është zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës si Avokat i Popullit për të pasuar Z. Sami Kurteshin, i cili ishte emëruar si Avokat i Popullit i përkohshëm që nga qershori i vitit 2014.

¹⁶¹ Ndërkohë që me organigram parashihen 63 punëtorë, IAP ka 54 punëtorë, duke përfshirë stafin joshqiptar.

¹⁶² *Më lart*, fusnota 152.

¹⁶³ Ligji nr. 2004/3 kundër diskriminimit në Kosovë, 19 shkurt 2004.

¹⁶⁴ Kjo përfshin diskriminimin e drejtpërdrejtë, diskriminimin e tërthortë, ngacmimin, udhëzimin për diskriminim, viktimizim dhe veçim.

¹⁶⁵ *Si më lart* fusnota 165.

¹⁶⁶ Ligji nr. 05/L -020 për barazinë gjinore, 28 maj 2015.

Ligji i ri për mbrojtje kundër diskriminimit jep definicione më gjithëpërfshirëse në lidhje me mekanizmat dhe mjetet zbatuese, sidomos ato në lidhje me IAP-në dhe gjykatat, si dhe parasheh edhe sanksione.¹⁶⁷ Përveç funksionit të Avokatit të Popullit në monitorim të rasteve të diskriminimit¹⁶⁸, ligji i lartpërmendur i shton atij përgjegjësinë e veprimit si organ i barazisë¹⁶⁹, por nuk parasheh krijimin e një qendre për trajtim të barabartë apo të ndonjë mase të ngjashme për zbatim, duke lënë kështu një mangësi të konsiderueshme që duhet të adresohet për të pasur zbatim efektiv.¹⁷⁰ Megjithatë, zhvillimi i strukturave të brendshme menaxhuese të IAP-së nuk është i plotë, dhe Ligji i ri për mbrojtje nga diskriminimi parasheh aktet nënligjore që të nxirren brenda gjashtë muajsh nga miratimi i tij.¹⁷¹

Monitorimi i kryer nga OSBE-së nuk ka gjetur ndonjë progres substancial në implementim, përkundër këtyre zhvillimeve të rëndësishme normative, duke mos pasur asnjë rast të parashtruar në gjykata që drejtpërdrejt i referohet diskriminimit. Rastet që kanë arritur në gjykata e me baza të ndryshme të tjera (si dhuna në familje dhe punësimi) si dhe të cilat mund të kenë përmbajtur elemente të diskriminimit, nuk janë trajtuar si raste të diskriminimit nga personat përgjegjës për procedimin dhe gjykimin e tyre. Për më tepër, vetëdijesimi mbi legjislacionin kundër diskriminimit si dhe obligimet tek gjyqësori, institucionet e Kosovës dhe publiku i gjerë janë vlerësuar si të kufizuara nga OSBE gjatë periudhës së raportimit, përkundër obligimit institucional për të promovuar barazi dhe për të hartuar e iniciuar programe për vetëdijesimin publik¹⁷².

Sfidat e mbetura

Monitorimi i kryer nga OSBE-ja tregon mangësi të konsiderueshme në kapacitetet e institucioneve gjyqësore për t'u përballur në mënyrë efektive me rastet e diskriminimit kur ka të tilla. Fushat kryesore për zhvillim kapacitetesh dhe trajnime, të identifikuar nga vlerësimet e OSBE-së, janë përfaqësimet strategjike në gjykatë, identifikimi dhe përcjellja e rasteve të diskriminimit, vetëdijesimi dhe raportimi. Aktorët kryesorë, duke përfshirë këtu IAP-në dhe institucionet e tjera të Kosovës ballafaqohen me mangësi në kapacitetet e tyre për t'i zbatuar përgjegjësitë dhe mandatin e tyre lidhur me promovimin e barazisë dhe parandalimin e diskriminimit. Zbatimi i Ligjit të vitit 2015 për mbrojtje nga diskriminimi do të varet shumë nga vetëdija publike për mjetet në dispozicion: mbesin sfida serioze në kuptimin e përmbushjes nga institucionet e Kosovës të obligimit për promovimin të barazisë përmes rritjes së vetëdijes publike.

¹⁶⁷ Neni 12 i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi (*si më lart* fusnota 155) përfshin një mekanizëm ankesash, ku personat mund të parashtrorin kërkesën e tyre tek IAP-ja, neni 9.2.12 obligon IAP-në që të dorëzojë raporte vjetore mbi zbatimin e Ligjit tek Kuvendi i Kosovës, ndërsa nenet 13 deri në 17 i referohen gjykatave.

¹⁶⁸ Në praktikë, IAP-ja, mes funksioneve të tjera, monitoron edhe rastet e diskriminimit. Një prej pesë zëvendësve udhëheq Departamentin Anti-Diskriminim, i cili ndahet në gjashtë njësi, të cilat mbulojnë të drejtat e fëmijëve, barazinë gjinore, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, trafikimin me qenie njerëzore dhe dhunën në familje, të drejtat e komuniteteve dhe çështjet sociale, si dhe të drejtat e personave lezbikë, homoseksualë, biseksualë dhe transgjitorë.

¹⁶⁹ Organ i barazisë është mekanizëm për promovimin, monitorimin dhe përkrahjen e trajtimit të barabartë pa asnjë diskriminim në baza të mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji kundër diskriminimit

¹⁷⁰ Shih Rekomandimin 6 nga përmbajtja e këtij raporti.

¹⁷¹ Neni 26 i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, *më lart* fusnota 165.

¹⁷² Edhe ligji i ri edhe ai i mëparshmi përfshijnë obligimin pozitiv për të promovuar dispozitat e ligjit (për shembull, neni 25 për Vetëdijesimin publik, Ligji i vitit 2015 për mbrojtje nga diskriminimi, *si më lart* fusnota 165).

2. KTHIMI DHE RIINTEGRIMI

Rekomandimi 8

Të përmirësohet bashkërendimi qendror i ndihmës për të kthyerit, përmes mbikëqyrjes dhe udhëzimeve të fokusuara, si dhe të sigurohet trajnimi i përshtatshëm i zyrtarëve komunalë; të bëhen përpjekje për të promovuar kthimin e qëndrueshëm përmes granteve të shënjestruara si dhe masave të tjera me qëllim të krijimit të vendeve të punës dhe mundësive të afarizmit në lokacione më të largëta.

Gjendja e tanishme

Sipas të dhënave nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), nga 220,000 personat e zhvendosur jashtë Kosovës, vetëm 26,098 janë kthyer që nga konflikti i vitit 1999 si dhe trazirat e vitit 2004.¹⁷³ UNHCR gjithashtu vlerëson që 17,227 persona janë të zhvendosur brenda vendit, ku 579 individë ende jetojnë në 32 qendra kolektive në gjithë Kosovën¹⁷⁴. Gjatë periudhës raportuese qershor 2014 deri më korrik 2015, ka pasur një rritje të vogël të kthimeve vullnetare të PZH drejt Kosovës, me 769 persona të zhvendosur që janë kthyer, në krahasim me 682 më 2014.¹⁷⁵ Megjithatë, vlerësimet e OSBE-së dhe UNHCR-së janë që në kuptimin e përgjithshëm, interesimi për t'u kthyer është ulur në masë të konsiderueshme në vitet e fundit.¹⁷⁶

Monitorimi i OSBE-së vlerësonte që nga 479 incidente të sigurisë që prekin pjesëtarët e komuniteteve të regjistruara gjatë periudhës së raportimit, (siç thuhet në Rekomandimin 2) rreth 22 për qind kanë prekur të kthyerit, ku serbët e Kosovës kanë qenë komuniteti më së shpeshti i prekur.¹⁷⁷ Siç përmendet më sipër, (në Rekomandimin 2) është bërë relativisht pak nga institucionet komunale dhe qendrore për të dekurajuar incidentet e tilla, të cilat pashmangshëm ndikojnë tek qëndrueshmëria e kthimit dhe interesimit të ardhshëm për t'u kthyer.

Krijimi i ZKKK-ve në shumicën e komunave të Kosovës është gjë pozitive¹⁷⁸. Megjithatë, monitorimi i kryer nga OSBE-ja identifikon përputhshmëri përgjithësisht të dobët me obligimin e tyre për t'u angazhuar në aktivitete përafrimi për t'i informuar të kthyerit dhe vlerësuar nevojat e tyre, apo për të identifikuar e zbatuar projekte me përfitues të kthyerit. Gjatë periudhës së raportimit, vetëm 11 ZKKK kanë pasur vizita të tilla komunikuese, por asnjëra aq shpesh¹⁷⁹. Task-forcat për kthim dhe grupet punuese komunale për kthim, mekanizmat komunalë që kanë për mandat të përkrahin punën e ZKKK-së, nuk janë krijuar

¹⁷³ Pasqyra tremujore statistikore, UNHCR, qershor 2015.

¹⁷⁴ *Si më lart* fusnota 173.

¹⁷⁵ *Si më lart* fusnota 173. Duhet theksuar që kjo rritje e vogël mund t'i atribuohet faktit që gjatë kësaj periudhe është implementuar faza e IV e Projektit të BE-së për Kthim dhe Riintegrim, duke ofruar përkrahje në riintegrim të personave.

¹⁷⁶ Shih Raportin e OSBE-së për Procesin e Kthimit Vullnetar, *si më lart* fusnota 31.

¹⁷⁷ Përgjithësisht, këto incidente të lidhura me lokacionet e kthimit janë të përqendruara në rajonin e Pejës/Peć, me një numër më të vogël të incidenteve që janë regjistruar në rajonet e Prizrenit, Mitrovicës/Mitrovica dhe Ferizajt/Uroševac. Më shumë informata mbi sigurinë që ndikon mes tjerash tek kthimi mund të merren tek Rekomandimi 2 i këtij raporti.

¹⁷⁸ *Si më lart*, fusnota 127.

¹⁷⁹ ZKKK-të në Skenderaj/Srbica, Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdë, Parteš/Partesh, Ranilug/Ranillug, Deçan/Deçane, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina dhe Pejë/Peć kanë bërë vizita kontaktuese, ku vetëm katër komuna kanë pasur mbi katër vizita gjatë periudhës së raportimit.

në të gjitha komunat, si dhe vazhdojnë të mos funksionojnë si duhet.¹⁸⁰ Për shkak të mungesës së kornizës ligjore për zhvendosjen dhe kthimin, ZKKK-të dhe institucionet lokale vazhdojnë t'i zbatojnë procedurat në bazë të një doracakut të vjetërsuar të UNMIK-ut dhe udhëzimeve jo të plota të politikave,¹⁸¹ duke çuar kështu drejt problemeve praktike në bashkërendim dhe implementim të përkrahjes për të kthyerit, përfshirë këtu llogaridhënien. Institucionet qendrore kanë dështuar në ofrimin e trajnimeve për ZKKK-të gjatë periudhës së raportimit, e edhe në adresimin e nevojës urgjente për një databazë të centralizuar për të përcjellë dhe shënuar ndihmën e dhënë.

MKK-ja pjesërisht ka adresuar mangësitë në kornizën ligjore në lidhje me zhvendosjen në marsin e vitit 2014, me një iniciativë të papërfunduar për personat e zhvendosur brenda vendit¹⁸², por ka bërë progres të rëndësishëm që prej atëherë në fillimin e hartimit të një rregulloreje për zhvendosjen.¹⁸³ Në maj të vitit 2015, MKK-ja ka themeluar një Grup Ndërmintor Pune për Kthimin¹⁸⁴ për të inkurajuar kthimin, për të mbyllur qendrat e mbetura kolektive, për të përkrahur bashkëpunimin rajonal për kthimin, si dhe për të përkrahur themelimin e tri grupeve lokale të punës në lokacione veçanërisht të vështira.¹⁸⁵ Çështjet e pazgjidhura pronësore kanë vazhduar të pengojnë gëzimin e të drejtave pronësore¹⁸⁶ nga personat e zhvendosur dhe dhjetë komuna kanë ndërmarrë hapa për të ndarë tokë për projektet e ndërlidhura me kthimin¹⁸⁷, ndërsa të tjerat nuk kanë pasur mundësi të bëjnë ndarje të tilla për shkak të pengesave që përfshijnë regjistrat jo të plotë të tokave komunale, procedurave të paqarta ligjore për rivendosjen e tokave të ndërmarrjeve shoqërore dhe për këmbimin e tokave me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Peticionet që janë parashtruar nga komunitetet e mundshme pritëse në formë proteste kundër kthimit kanë qenë një pengesë tjetër ndaj kthimit në gjashtë komuna, gjatë periudhës së raportimit.¹⁸⁸ Disa veprime pozitive janë ndërmarrë nga institucionet e Kosovës për të njoftuar personat e zhvendosur për procedurat e shpronësimit¹⁸⁹, si dhe me mbështetje ndërkombëtare, personat e

¹⁸⁰ Brenda periudhës së raportimit, grupet komunale punuese për kthimin janë krijuar në 24 nga 38 komuna, ndërsa vetëm 16 nga këto të themeluara kanë qenë funksionale. Për më tepër, funksionimi i këtyre grupeve komunale të punës për kthimin ka qenë ekskluzivisht i lidhur me implementimin e Fazës II dhe Fazës IV të Projektit të BE-së për Kthim dhe Riintegrim (RRK) në të gjitha këto komuna, përveç në dy prej tyre.

¹⁸¹ *Protokolli për Kthimin Vullnetar dhe Kthimin e Qëndrueshëm* (ndërmjet UNMIK-ut dhe Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë dhe Qeverisë së Serbisë, 2006), i përfshirë në *Doracakun e Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm* (2006), plotësuar me *Udhëzimet për implementim të përkrahjes për kthimin* (2012).

¹⁸² Kjo iniciativë për PZHV-të është dashur të fillonte me një vlerësim, por aktivitetet nuk kanë ecur tutje për shkak të mungesës së fondeve dhe problemeve me grumbullimin e të dhënave në komunat veriore.

¹⁸³ MKK-ja ka mbledhur një grup teknik për hartimin e rregullores për kthimin dhe riintegrimin në shtator të vitit 2015, me qëllim të finalizimit të saj më 2015.

¹⁸⁴ Themeluar më 3 qershor 2015: Synimet strategjike të Grupit Punues mund të gjenden tek: <http://www.mkk-ks.org/?page=2,6>.

¹⁸⁵ Brđani/Kroi i Vitakut (Mitrovica/Mitrovicë e Veriut) Svinjare/Frashër (Mitrovicë/Mitrovica e Jugut), si dhe Mushtishtë/Mušutište (Suharekë/Suha Reka).

¹⁸⁶ Sfidat kryesore janë rastet e padive të pazgjidhura për kompensim (afërsisht 22,000), problemet me dëbime dhe ri-dëbime, (ri)uzurpimet e paligjshme dhe pagesat e tatimeve në pronë. Përveç këtyre, zgjidhjet e qëndrueshme të banimit kufizohen me probleme të komunave në ndarje të tokave. Personat e zhvendosur gjithashtu janë prekur nga mangësitë në zbatimin e shpronësimit dhe legalizimit të ndërtimeve pa leje.

¹⁸⁷ Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Ranilug/Ranillug, Istog/Istok, Parteš/Partesh, Lipjan/Lipljan, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Šterpce/Shtërpce, Gračanica/Graçanicë.

¹⁸⁸ *Si më lart*, fusnota 33.

¹⁸⁹ Rregulluar me Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronave të Paluajtshme, 28 tetor 2010. Sipas nenit 7.3.4.1, janë organizuar tre dëgjime publike në shkurt të vitit 2015, si dhe janë ndjekur nga pronarët jo-shqiptarë të pronave të cilët kanë pasur mundësi të flasin për brengat dhe të marrin sqarime të tjera. Njoftimi

zhvendosur nga Kosova që aktualisht jetojnë në disa lokacione nëpër Serbi kanë përfituar nga fushatat informuese për rritjen e njohurive për procedurat dhe afatet e aplikimit për legalizim të ndërtimeve pa leje.¹⁹⁰

Strategjia e rishikuar e MKK-së për komunitete dhe kthim¹⁹¹ paraqet përparim në kuptimin që ka zhvilluar synimet konkrete strategjike për kthimin e qëndrueshëm dhe fuqizimin e komuniteteve, trajtimin e çështjeve siç janë qëndrueshmëria e kthimit, ndarja e tokës, proceset e përzgjedhjes, mbyllja e qendrave kolektive, por edhe bashkërendimi institucional dhe menaxhimi i të dhënave. Që prej miratimit të strategjisë në janar të vitit 2014, shifrat e UNHCR-së tregojnë që numri i personave që jetojnë në qendra kolektive ka rënë nga 663 në 585 në qershorin e vitit 2015. Meqë MKK nuk ka hartuar asnjë raport të progresit, nuk është e qartë nëse ky reduktim është si pasojë e veprimit institucional apo zgjidhjeve personale që janë gjetur nga ish-banorët e qendrës kolektive. Qendra e fundit e përkohshme kolektive në Leposavić/Leposaviq për familjet e zhvendosura egjiptiane, rome e ashkali të Kosovës është mbyllur zyrtarisht në dhjetor të vitit 2013¹⁹². Megjithatë, tre familje refuzuan të rivendoseshin për shkak të brenave të sigurisë dhe organizata joqeveritare Mercy Corps vazhdon të kërkojë alternativa për vendosje të qëndrueshme të tyre. Deri tani, Mercy Corps ka hasur në hezitim nga komuna dhe komunitetet e afërta pritëse për ndarje të tokës ose renovim të pronës për këto familje. Monitorimi i kryer nga OSBE tregoi se gjatë periudhës së raportimit ZKKK-të dhe MKK-ja kanë ofruar mbështetje për PZH-të e kthyer kryesisht përmes projekteve të banimit dhe ofrimit të pakove emergjente.¹⁹³

Sfidat e mbetura

Pa një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për PZH-të dhe procese dhe mekanizma për të ndihmuar dhe mbështetur personat që dëshirojnë të kthehen, duke përfshirë një bazë qendrore të të dhënave, realizimi i asistencës së lidhur me kthimet do të vazhdojë të jetë problematik. Rregullimi i bashkërendimit ndërmjet trupave të nivelit qendror dhe lokal dhe funksionimi i mekanizmave përgjegjës do të jetë hap i rëndësishëm. Çështjet e pazgjidhura të pronës kanë ndikim të konsiderueshëm në kthimet dhe PZH-të vazhdojnë të jenë në pozitë të pafavorshme në kuptim të qasjes në informata: pengesat në ndarjen e tokës faktikisht kanë bllokuar apo kanë ulur ndjeshëm kthimin e disa familjeve të zhvendosura jashtë Kosovës, të cilët përndryshe do të ishin proceduar. Veprimi i plotë dhe efektiv institucional për programet e lidhura me kthimin në nivel lokal dhe qendror vazhdon të pengohet nga mungesa e përkrahjes

për shpronësim i është dorëzuar pronarëve të prekur në të dyja gjuhët, shqip e serbisht, sipas obligimit në nenin 7.2 të Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, 27 korrik 2006.

¹⁹⁰ Ligji nr. 04/L-188 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, 26 dhjetor 2013, parasheh regjistrimin e të gjitha ndërtimeve të tilla deri më 5 shkurt 2015, më vonë zgjat deri më 11 qershor 2015.

¹⁹¹ *Strategjia për Komunitete dhe Kthim (2014–2018)* ka katër synime strategjike: kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur brenda Kosovës dhe në rajon; fuqizimi dhe stabilizimi i komuniteteve në Kosovë; hartimi dhe plotësimi i kornizës ligjore të MKK-së në lidhje me komunitetet, kthimin dhe riintegrimin; si dhe avancimi i menaxhimit të brendshëm të MKK-së.

¹⁹² Familjet nga kampi janë zhvendosur në Mahallën Rome në Mitrovicën /Mitrovica e Jugut si pjesë e një projekti të financuar nga BE-ja/IPA, implementuar nga Mercy Corps.

¹⁹³ Për shembull, komuna Novo Brdo/Novobërdë ka ofruar strehim të përkohshëm për një familje të kthyer, derisa ZKKK-ja në Lipjan/Lipljan ka përkrahur një familje ashkali me dru zjarri dhe artikuj të tjerë ushqimorë dhe jo-ushqimorë, ngjashëm me shpërndarjen nga Komuna e Ferizajt/Uroševac të ushqimit dhe artikujve të tjerë për 18 familje serbe gjatë Pashkëve Ortodoksë. Komunitat Obiliq/Obiliç dhe Klinë/Klina kanë ndarë tokë dhe kanë përkrahur ndërtimin për një numër të konsiderueshëm të kthyerve, e veçanërisht për 52 shtëpi në Plemetin/Plemetina si pjesë e një projekti të financuar nga donatorët.

strategjike nga disa institucione të përfshira të Kosovës, jo vetëm MKK, por edhe MAPL, MASHT, MPB, PK, etj.

3. KULTURA DHE MEDIAT

Rekomandimi 10

Të krijohet një mekanizëm transparent, bazuar në kritere objektive dhe procedura të qarta të aplikimit, për dhënien e mbështetjes për aktivitete kulturore të të gjitha komuniteteve pakicë; të bëhen përpjekje për t'i përfunduar punët e pakryera të nevojshme si pasojë e dhunës së marsit 2004, si dhe të sigurohet sigurimi adekuat për lokalitetet kulturore dhe fetare të të gjitha pakicave, duke përfshirë zonat e veçanta të mbrojtura.

Gjendja e tanishme

Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit (MKRS) ka kërkuar rishikimin e Ligjit për trashëgiminë kulturore, por nuk arriti të konsultohet me komunitetet dhe grupet fetare. Megjithatë, ligji ishte tërhequr për konsultime të mëtejshme menjëherë pas dorëzimit të tij në KK në maj të vitit 2015. Në fillim të vitit 2015, MKRS-ja inicioi hartimin e një strategjie për trashëgiminë kulturore, që pritej të ofronte udhëzime të politikave në këtë fushë. MKRS-ja lansoi një bazë të të dhënave të trashëgimisë kulturore në korrik 2014, duke listuar deri tani afërsisht 200 nga 1,441 monumentet e trashëgimisë kulturore¹⁹⁴ nën mbrojtje të përkohshme. MKRS zbatoi një projekt të intervenimit emergjent, që përfshinte punë urgjente për mbrojtjen e 36 nga 50 ndërtesave prioritare. MKRS-ja gjithashtu shpalli një projekt për vizualizimin e monumenteve¹⁹⁵ në 2013, me vazhdim të punëve në 2014, me qëllim që të mbështesë dokumentimin dhe promovimin digjital të objekteve të trashëgimisë kulturore¹⁹⁶.

Monitorimi i kryer nga OSBE ka vërejtur përparim të rëndësishëm në trajtimin e mangësive normative në çështjet e trashëgimisë kulturore që nga raporti i fundit i Vlerësimit të të Drejtave të Komunitetit. Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligji për fshatin Hoça e Madhe janë miratuar¹⁹⁷, duke përcaktuar aktivitetet e kufizuara apo të ndaluara brenda këtyre dy zonave. Këto ligje u pasuan me dy udhëzime administrative, që rregullojnë themelimin dhe funksionimin e dy këshillave përkatës dhe ato u miratuan në prill të vitit 2014¹⁹⁸. Monitorimi i kryer nga OSBE ka shënuar se Këshilli i Prizrenit ka mbajtur takime mujore gjatë gjithë periudhës për të cilën raportohet (duke tejkaluar obligimin për takime tremujore),

¹⁹⁴ Këto përfshijnë trashëgiminë arkitektonike, arkeologjike dhe të luajtshme.

¹⁹⁵ Kjo nismë mundëson përdorimin e teknikave të reja të digjitalizimit, duke përfshirë: i) fotografitë panoramike, ii) konservimin e trashëgimisë kulturore, iii) storien/narrativen (ecja virtuale). Projekti është i bazuar në “Projektin Google Wonders” të mbështetur nga UNESCO.

¹⁹⁶ Promovimi digjital i projektit global të trashëgimisë “Wiki Loves Monuments” që synon të promovojë dhe dokumentojë trashëgiminë kulturore, tani i zbatuar për herë të parë në Kosovë, me mbështetje institucionale dhe të shoqërisë civile.

¹⁹⁷ Ligji nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, 18 korrik 2012 dhe ligji nr. 04/L-062 për Fshatin Hoça e Madhe, 18 korrik 2012, janë miratuar sipas ligjit nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, 04 qershor 2008, neni 7 (m) dhe neni 8. Këto dy ligje përcaktojnë rregullat për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të dy zonave.

¹⁹⁸ Udhëzimi administrative nr. 12/2014 për themelimin, përzgjedhjen dhe përgjegjësitë për veprimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore dhe Zyrën e Qendrës Historike të Prizrenit, 29 prill 2014; Udhëzimi administrative nr. 11/2014 për themelimin, përzgjedhjen dhe përgjegjësitë për veprimin e Këshillit Fshatit Hoça e Madhe, 29 prill 2014.

duke diskutuar dhe shqyrtuar aktivitetet në zonën e veçantë të mbrojtur (ZVM)¹⁹⁹. Komuna e Prizrenit gjithashtu ka emëruar një administrator në 2014 dhe në 2015 ka ndarë hapësirë për zyre për Këshillin, siç kërkohet. Këshilli për ZVM-në Hoça e Madhe është themeluar në janar të vitit 2015, dhe në tetor 2015 janë siguruar buxhetet për vitin përkatës për të dy Këshillat.

Megjithatë, sipas statistikave vjetore të KP-së për vitin 2014, janë regjistruar 87 sulme të drejtuara në lokalitete të trashëgimisë fetare gjatë vitit në fjalë, 42 prej të cilave ishin të drejtuara ndaj lokacioneve ortodokse, 40 të drejtuara ndaj lokacioneve myslimane dhe 5 të drejtuara ndaj lokacioneve katolike; ky total reflekton të njëjtin numër sulmesh të regjistruara nga PK vitin paraprak, ku nuk ka rënie që nga raporti i fundit për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve.²⁰⁰ Monitorimi i kryer nga OSBE gjatë periudhës qershor 2014 deri në korrik 2015 gjithashtu ka regjistruar raste të frikësimit dhe kërcënimeve ndaj personave që u përkasin komuniteteve fetare të pakicave, si murgeshat dhe priftërinjtë: këto incidente përfshinin gjuajtjen me gurë në shtëpitë e famullisë dhe përpjekje për të penguar apo që shënjestruar udhëtimin e pelegrinëve në lokacione fetare²⁰¹. Ndërtimet e paligjshme në ZVM vazhdojnë të jenë çështje problematike, me disa incidente të regjistruara gjatë periudhës së raportimit²⁰². Pavarësisht kësaj, bashkëpunimi dhe marrëdhëniet mes institucioneve të Kosovës dhe Kishës Ortodokse Serbe (KOS) janë përmirësuar, mes tjerash, përmes Këshillit për Zbatim dhe Monitorim e (KZM)²⁰³. KOS është konsultuar më shpesh nga institucionet e Kosovës gjatë periudhës së raportimit, përmes KZM-së dhe organeve komunale, sesa në të kaluarën, sidomos në rastet që kanë të bëjnë me vendimet që prekin hapësirat e ZVM-ve. Hapa të tjerë pozitivë përfshinin ndërtimin e marrëdhënieve ndërmjet KOS-it dhe udhëheqësve komunalë përmes vizitave dhe diskutimeve mbi problemet lokale.²⁰⁴ Marrëdhëniet ndërmjet KOS dhe institucioneve të Kosovës janë sfiduar megjithatë në kontekst të përpjekjeve të fundit të institucioneve të Kosovës për anëtarësim në UNESCO.

¹⁹⁹ Neni 16, Ligji nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, 18 korrik 2012, përcakton që Këshilli duhet të jep opinione për kërkesat për lejet e ndërtimit, rrënimin, modifikimin apo ndryshimin e destinimit të ndërtesave, kryerjen e aktiviteteve të përkohshme apo zhvillimet e tjera brenda Qendrës Historike të Prizrenit.

²⁰⁰ Sipas statistikave vjetore të KP-së për 2013, ka pasur 87 sulme të drejtuara ndaj lokacioneve fetare, në mënyrë specifike, 41 të drejtuara ndaj lokacioneve ortodokse serbe, 31 drejt lokacioneve myslimane, 9 drejtuar ndaj lokacioneve katolike dhe gjashtë ndaj vendeve të tjera fetare apo kulturore. PK nuk i kategorizon këto të dhëna në kuptim të asaj nëse lokacionet e shënjestruara janë të komuniteteve në pakicë numerike në nivel komunal (p.sh. lokacionet e shqiptarëve mysliman dhe katolik në komunat me shumicë serbe, p.sh. lokacionet myslimane të boshnjakëve të Kosovës në komunat me shumicë shqiptare, etj.).

²⁰¹ Ishin shtatë raste të tilla të regjistruara gjatë periudhës së raportimit, duke përfshirë edhe disa kërcënime telefonike ndaj murgeshave në Manastirin e Goricit, kërcënime ndaj priftërinjve ortodoksë serbë në Istog dhe Prishtinë, gjuajtjen me gurë ndaj shtëpive të famullisë në Rahovec dhe Vushtrri, dhe hedhjen e vezëve ndaj konviktit katolik studentor në Prishtinë. Përveç kësaj, pelegrinët janë penguar nga qasja në manastirin në qytetin e Gjakovës dhe manastirin e shkatërruar në Mushtishtë, Suharekës.

²⁰² Për shembull: ZVM Manastiri i Deçanit, ku është ndërtuar një fermë peshku dhe një restorant, si dhe ZVM e Patriarkanës së Pejës, ku janë ndërtuar kasolle prej druri që përdoren për kafene dhe një urë e improvizuar prej druri.

²⁰³ Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, 4 qershor 2008, parasheh themelimin e KZM-së i cili është përgjegjës për monitorimin dhe lehtësimin e ZVM-ve. Takimi i parë i KZM-së u mbajt më 26 shkurt 2013 dhe deri në fund të qershorit 2015 KZM kishte zgjidhur disa raste të lidhura me ndërtimet pa leje në ZVM-të, si dhe ka ofruar zgjidhje për probleme të tjera.

²⁰⁴ Për shembull: marrëveshja afatgjate me qira për një pronë banesore në pronësi nga Manastirit të Deviqit, të nënshkruar me komunën e Skenderajt, dhe vizitën hyrëse në shtator 2014 të zyrtarëve të Skenderajt në Manastirin e Deviqit; takimi midis kryetarit të Pejës dhe Patriarkanës së Pejës; dhe, rithemelimi i marrëdhënieve në mes të kryetarit të komunës së Deçanit dhe Manastirit të Deçanit përmes një vizite komunale në manastir në mars 2015 për të diskutuar për mirëmbajtjen e rrugëve, përcjellë me vizitën e kryetarit për Pashkët ortodokse.

Mbështetja institucionale për të promovuar kulturën dhe traditën e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane dhe ishte e kufizuar kryesisht në festimet për Ditën e Romëve. Ndërsa shumë komuna nuk e kanë shënuar këtë ditë, gjashtë komuna kanë ofruar mbështetje të konsiderueshme për këto aktivitete, përfshirë financimin. Monitorimi i kryer nga OSBE vuri në dukje se aktivitetet e tilla më nuk janë të kufizuara në muzikë ose valle, dhe tani kanë filluar të përfshijnë diskutime mbi gjendjen sociale të komunitetit dhe ngjarje në gjuhën rome.²⁰⁵

Sfidat e mbetura

Numri i incidenteve që prekin lokalitetet e trashëgimisë kulturore dhe fetare të komuniteteve është tejet shqetësues, me ndikime negative edhe në marrëdhëniet ndëretnike edhe në të drejtat e komuniteteve për ta gëzuar trashëgiminë e tyre edhe për të përfituar nga ajo. Ndërtimet e paligjshme në ZVM janë ende problematike dhe institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë përgjigje adekuate dhe në kohë, duke përfshirë masat parandaluese dhe vizitat e rregullta në terren: roli dhe kompetencat e inspektorëve mbeten pa atë nivelin e kërkuar të udhëzimit. Trajtimi i mangësive nga institucionet qendrore për trashëgiminë kulturore mbetet sfidues duke pasur parasysh tërheqjen e ligjit të propozuar për Trashëgiminë Kulturore; duhen mbajtur konsultime për projektligjin bashkë me përfaqësues të të gjitha komuniteteve, përfshirë bashkësitë fetare, për të siguruar që janë pasqyruar shqetësimet dhe nevojat e tyre. Burimet financiare vazhdojnë të jenë të kufizuara dhe përkundër zbatimit të disa projekteve pozitive me mbështetje të MKRS-së, është e rëndësishme që komunitetet të kenë qasje në mundësitë dhe fondet për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Rekomandimi 11

Të rritet prania e gjuhëve të komuniteteve pakicë në transmetuesin publik dhe mediat e shtypura dhe të sigurohet se shqetësimet e komuniteteve, duke përfshirë edhe ato numër më të vogël, pasqyrohen në mënyrë adekuate dhe objektive; të merren masa të vendosura për të rritur pjesëmarrjen efektive të përfaqësuesve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në bashkërendimin dhe zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimt, si dhe të rritet përfaqësimi i tyre në administratën publike.

Gjendja aktuale

Monitorimi i kryer nga OSBE në vitin 2013 vuri në dukje progresin e arritur në qasje në mediat transmetuese dhe të shkruara në gjuhët e komuniteteve numerikisht më të vogla. Transmetimi publik në gjuhën serbe nga Radiotelevizioni i Kosovës 2 (RTK2) që filloi në qershor 2013, ndanë 15 për qind të kohës transmetuese për programet në gjuhët e

²⁰⁵ Komuna e Graçanicës organizoi festimet në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Romëve me shfaqje nga grupe folklorike dhe lexime poetike, duke përfshirë 5,485 € të financimit për një dokumentar. Komuna e Pejës dhe Prizrenit kanë mbështetur ekspozita me piktura, fotografi, veshje tradicionale dhe artizanate, si dhe tryeza të rumbullakëta për t'i diskutuar të arriturat dhe sfidat e komunitetit rom në Kosovë. Prizreni ka mbështetur një shfaqje teatrale në gjuhën rome me 1,000 €, Peja ka ndarë 400 € për aktivitete kulturore, dhe Ferizaj mbështeti një performancë të muzikës dhe valleve kombëtare rome. Në Gjakovë një OJQ lokale organizoi një ekspozitë artistike të të rinjve si pjesë e "javës rome" në mes të 5 dhe 10 prillit, sikurse edhe Deçani që kishte mbështetur romët, përmes organizimit të tryezave të rumbullakëta.

komuniteteve të tjera²⁰⁶. Veç kësaj, përmirësime janë vërejtur nga OSBE në cilësinë e raportimit dhe disponueshmërinë e informacionit për komunitetet. Progres është arritur edhe me kërkesë të përfaqësuesve të ashkalive dhe egjiptianëve në kanal in e parë të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK1) për programin në gjuhën shqipe kushtuar komuniteteve të tyre²⁰⁷, ku gjatë periudhës së raportimit është vërejtur transmetimi i parë i një programi televiziv publik kushtuar këtyre dy komuniteteve në fillim të 2014. RTK1 shënoi ‘Ditën e ashkalive’ në shkurt të vitit 2014, përmes një programi mujor dedikuar këtij komuniteti, dhe pas kësaj në qershor të vitit 2015 me fillimin e programit mujor kushtuar egjiptianëve të Kosovës “Spektri Egjiptian”. RTK1 gjithashtu vazhdon të transmetojë program javor prej 45 minutash në gjuhën rome, si dhe një program 15-minutësh të lajmeve ditore²⁰⁸. Megjithatë, RTK1 si tërësi ende nuk vepron në përputhje me programimin e kërkuar në gjuhët e komuniteteve ku, për shembull, programimi në gjuhën boshnjake ende nuk ka filluar. Megjithatë, komunitetet kanë përfaqësim të duhur në bordin drejtues ku të gjitha ‘ulëset e ndara’ për komunitete janë të plotësuara si duhet²⁰⁹. Mediat private gjithashtu mbështesin transmetimin për komunitetet: radiostacionet private në Prizren dhe Gjakovë transmetojnë programe që synojnë romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës, dhe gjithashtu publikohet një revistë e drejtuar nga një OJQ mbi kulturën rome dhe shqiptare, me financim ndërkombëtar.²¹⁰

Megjithatë, monitorimi i kryer nga OSBE vazhdon të vërejë paragjykime etnike në raportimin e medieve dhe aftësinë e tyre për t’i pasqyruar shqetësimet dhe problemet e komuniteteve të tjera. Monitorimi i tillë i mediave transmetuese dhe të shtypura tregon se informatat që janë përdorur për t’i raportuar çështjet, veçanërisht ato në lidhje me zhvillimet politike dhe incidentet ndëretnike, vazhdojnë shpesh të sigurohen nga burime të të njëjtit komunitet e të cilat shpeshherë janë të pavërtetuara. Aktivitetet e rregullta monitoruese të kryera nga OSBE gjejnë se raportimi i mediave për incidentet e sigurisë shpeshherë përfshin referenca në përkatësinë etnike të kryerësve të konfirmuar apo të pretenduar, edhe nëse incidenti nuk ishte i motivuar në baza etnike apo politike. Këshilli i Mediave të Shkruara i Kosovës ka vazhduar të pranojë ankesa për praktikë të pakënaqshme të etikës profesionale gjatë periudhës së raportimit.²¹¹ Për më tepër, përkundër ekzistimit të kodit të sjelljes së

²⁰⁶ Vëreni që RTK2 transmetohet vetëm përmes rrjetit kabllor për shkak të mungesës së frekuencave në Kosovë. 85% të transmetimit të RTK2 është në serbisht, gjersa 15% të tjera ndahen për gjuhët e tjera joshqiptare e joserbe.

²⁰⁷ Para këtij zhvillimi të ri, kjo kërkesë nga përfaqësuesit ashkali dhe egjiptianë të Kosovës nuk kishte marrë përgjigje që nga 2012 (siç është cekur në Opinionin e Tretë, faqe 31-32)..

²⁰⁸ Monitorimi i kryer nga OSBE ka vërejtur programin javor të ketë filluar më 2011, dhe ai ditor më 2013.

²⁰⁹ Nga 11 anëtarë të bordit të RTK1, dy janë të rezervuar për përfaqësues serbë dhe një tjetër për një përfaqësues të një komuniteti tjetër joshqiptar: gjatë periudhës së raportimit ky përfaqësues është siguruar nga komunitetet joshqiptare.

²¹⁰ Radio ‘Romano Avazo’ transmeton në gjuhën rome në Prizren (që nga vitit 2007), dhe ‘Prosperiteti’ në Gjakovë. Revista ‘Yekhipe’ (*Bashkimi*) publikohet nga OJQ Sakuntala, me botimin e fundit në maj 2015 me financim të Ambasadës së Holandës në Kosovë.

²¹¹ Në Kosovë, vetë-rregullimi i mediave është përgjegjësi e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, i themeluar në vitin 2005 për vetë-rregullimin e mediave të shkruara. Edhe pse ka arritur përparim në zbatimin e standardeve profesionale përmes mekanizmave të raportimit, ku të çdo person në Kosovë mund të paraqesë ankesë kundër raportimit të perceptuar si të pasaktë nga shtypi, roli i tij është i kufizuar në mediat e shtypura të cilët janë anëtarë të tij, dhe ende nuk ka anëtarësim gjithëpërfshirës. Për më shumë informacione përkritazi me ankesat, ju lutemi shihni: <http://presscouncil-ks.org/decisions/?lang=en>.

mediave transmetuese dhe mekanizmave për zbatim²¹², informatat e mbledhura nga OSBE tregojnë që ky mekanizëm rrallëherë shfrytëzohet dhe mediat në internet, që janë burim i rëndësishëm i raportimeve nxitëse, vazhdojnë të jenë të parregulluara ndonëse portalet e lajmeve janë të përfshira në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës. OSBE-ja nuk ka parë progres të mjaftueshëm në krijimin e medimeve dygjuhëshe për të mbuluar apo arritur një audiencë më të gjerë.

Sfidat e mbetura

Është shënuar progres në çështjen e mediave transmetuese në gjuhët e komuniteteve dhe për komunitetet është bërë, por ai duhet të vazhdojë. Nevoja për veprim për të siguruar se marrëdhëniet ndëretnike nuk cenohen përmes raportimit të papërgjegjshëm mbetet sfidë që ende nuk është trajtuar nga institucionet e Kosovës. Agjencitë e Kosovës për rregullim të mediave dhe vetë-rregullim, gjegjësisht sistemet dhe proceset e tyre për monitorim dhe sanksionim të sjelljes profesionale të mediave duhet të forcohen edhe më shumë, duke përfshirë edhe ato për mediat në internet, dhe mediat në veri të Kosovës duhet të inkuadrohen plotësisht në këto sisteme, përmes shoqatave dhe organeve profesionale.

KONKLUZA DHE REKOMANDIME

Brenda periudhës së raportimit dhe që nga raporti i fundit i Vlerësimit të të Drejtave të Komunitetit, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë disa hapa pozitivë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve siç përkrahjet në KKPK dhe sanksionet e mësipërme kanë dëshmuar hapa të tillë të ndërlidhura me rekomandimet. Një zhvillim shtesë që nga raporti i fundit është themelimi i Grupit Punues Teknik për të koordinuar zbatimin e KKPK-së, i cili është mbledhur një herë nën kryesimin e ZQM-së që nga vendimi fillestar në nëntor 2014²¹³: shpresohet se grupi do të takohet më rregullisht dhe se gjithashtu ZÇK do të luajë një rol të fuqishëm duke pasur parasysh mandatin dhe fokusin e saj për komunitetet. Në Rezolutën CM/Res/CMN (2014)13, Komiteti i Ministrave të KE-së nënvizoi fushat me interes përmes dymbëdhjetë rekomandimeve që ky raport ka vlerësuar, duke konkluduar që shumë prej këtyre shqetësimeve mbesin relevante. Institucionet e Kosovës duhet të shënojnë përparim më të madh për të siguruar që shoqëria dhe strukturat i marrin parasysh nevojat e të gjitha komuniteteve dhe promovojnë tolerancë dhe paqe.

Shqyrtimi i OSBE-së ka vërejtur disa zhvillime pozitive që lidhen me fushat me interes të identifikuar në Rezolutë, përfshirë progresin në dialogun politik ndërmjet Prishtinës/Priştina dhe Beogradit, si dhe për nismat në nivel lokal në promovim të kulturës dhe dialogut dhe për përmirësim të marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve. Përpjekjet e kohëve të fundit nga MKK-ja për trajtimin e kthimeve të vështira dhe për ty angazhuar në bashkëpunim rajonal për zgjidhje të qëndrueshme për të zhvendosurit nga Kosova janë gjithashtu me rëndësi. Liria e lëvizjes për shqiptarët që jetojnë në komunat veriore është përmirësuar dhe reagimet e përgjithshme të sigurisë janë forcuar nëpërmjet rritjes së dënimeve, themelimit më të madh

²¹² Komisioni i Pavarur për Media është institucion i pavarur i Kosovës përgjegjës për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit, duke përfshirë edhe kodin e mirësjelljes; ai përballet me një numër sfidash, duke përfshirë staf të kufizuar për monitorim në mbarë Kosovën.

²¹³ Grupi punues u themelua me Vendim të Zyrës së Kryeministrit 140/2014 më 10 nëntor 2014, më pas ndryshuar më 10 mars 2015, për të përfshirë tre anëtarë shtesë institucionalë, me përfaqësues të: ZQM (kryesues), MKK, Zyrës për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, MASHT, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Integritimit Evropian, MPB, IAP, ZKGj, MKRS dhe MAPL.

dhe anëtarësimi më përfshirës të KKSBB-ve dhe KLSP-ve në një numër komunash. Disponueshmëria e letërnjoftimeve në turqisht dhe dokumenteve të regjistrimit civil në boshnjakisht, turqisht dhe serbisht në alfabet cirilik paraqesin përparim në aspektin e të drejtave gjuhësore, siç është edhe angazhimi i shtuar i ZKGGj-së. Miratimi i legjislacionit dhe krijimi i këshillave në Prizren dhe Hoçë të Madhe kanë mbështetur mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Rritja e disponueshmërisë së mësimi në gjuhën romë në Prizren, dhe zgjerimi i programit medial në gjuhët e komuniteteve po ashtu paraqesin progres të shënuar.

Pavarësisht këtij progresi, ende mbetin shumë sfida të cilat kërkojnë veprime të përkushtuara nga institucionet e Kosovës, dhe duhet të theksohet se shumë rekomandime të paraqitura në vijim janë përsëritje të atyre të Raportit të Fundit të Vlerësimit të të Drejtave të Komuniteteve, të publikuar tri vite më parë. Përpjekjet për promovimin e dialogut, tolerancës dhe diversitetit janë të pakta, kryesisht të atypëratyshme dhe nxitura nga donatorët. Incidentet e vazhdueshme të sigurisë që kanë si cak komunitetet joshqiptare, veçanërisht të kthyerit, vazhdojnë të prekin perceptimet e komuniteteve të sigurisë. Një numër i konsiderueshëm i incidenteve që kanë për cak trashëgiminë fetare dhe kulturore të komuniteteve vazhdojnë të minojnë marrëdhëniet ndëretnike, ndonëse jo të gjitha janë patjetër krime të nxitura nga urrejtja apo të motivuara etnikisht. Raportimi i mediave vazhdon të jetë me paragjykime, me transmetime joadekuata të përmbajtjes shumëgjuhëshe dhe shumëkulturore. Veprimi i vazhduar i dy sistemeve të ndara arsimore dhe mundësitë e kufizuara për të mësuar gjuhët apo kulturore të komuniteteve të tjera e vazhdon ndarjen tek gjeneratat e ardhshme. Barrierat gjuhësore gjithashtu prekin qasjen në drejtësi, shpeshherë të kufizuar për komunitetet, veçanërisht duke pasur parasysh mungesën e shërbimeve të ndihmës juridike dhe çështjet e pazgjidhura pronësore vazhdojnë të paraqesin një numër problemesh, duke përfshirë për PZH-të. Komunitetet joshqiptare vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në shërbimin civil dhe përballesh me pengesa në punësim dhe vështirësi në qasjen në shërbime. Komunitetet më të prekura në këtë sferë janë ato romë, ashkali dhe egjiptiane, ku udhëheqësia dhe koordinimi i dobët institucional kanë lënë të paplotësuara angazhime të rëndësishme të politikave. IAP ka nevojë për staf dhe financim të duhur për të qenë në gjendje që të zbatojë përgjegjësitë lidhur me antidiskriminimin, duke përfshirë edhe vetëdijësimin publik. Së fundi, komunitetet numerikisht më të vogla vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në mekanizmat mbrojtës të e qeverisjes lokale, ndërsa ende nuk ka vende të rezervuara në KK për komunitetin kroat dhe malazez të Kosovës. Në vijim janë një sërë rekomandimesh për institucionet e Kosovës.

Për të gjitha institucionet përkatëse të Kosovës

- Të merren hapa pozitivë për t'i bashkuar ndarjet ndërmjet komuniteteve dhe promovuar pajtimin në nivel qendror dhe lokal, duke përfshirë ndërmjet komunitetit pritës dhe atij të kthyer. Këto hapa duhet të përfshijnë përpjekje për rritje të tolerancës dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve përmes sistemit arsimor, si dhe për t'i ngritur kapacitetet e aktorëve kyçë në mbështetje të dialogut ndërmjet komuniteteve, duke përfshirë NKK-të dhe ZKKKK-të.
- Të merren hapa për trajtimin e raportimit të paragjykuar dhe të njëanshëm përmes trajnimeve për gazetarë dhe përmirësimin të rregulloreve, duke përfshirë asaj për mediat në internet.
- Të ngrihen kapacitetet dhe resurset e IAP-it për t'i përmbushur efektshëm përgjegjësitë kundër diskriminimit, përfshirë përmes rekrutimit dhe trajnimit të stafit.
- Të hartohet një politike të re për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian bazuar në konsultime të vërteta, me financim adekuat dhe që parasheh përmirësim të ndjeshëm të

strukturave të bashkërendimit dhe llogaridhënies që përfshijnë pjesëtarët e të tri komuniteteve.

- Të merren hapa strategjikë dhe gjithëpërfshirës për t'i përmirësuar kapacitetet njerëzore për pajtueshmërinë gjuhësore dhe cilësinë e përkthimeve zyrtare, duke përfshirë programe studimore, të trajnimit dhe certifikimit për gjuhëtarë, përfshirë dhe ekspertizën ligjore.
- Të mbrohen të drejtat pronësore të PZH-ve duke i dhënë prioritet rasteve të pazgjidhura të lidhura me konfliktin, zbatimit të vendimeve dhe duke siguruar se informatat për procedurat e legalizimit dhe shpronësimit arrijnë tek personat e prekur. Përveç kësaj, të ndryshohet e plotësohet legjislacioni për të trajtuar çështjen e tatimit të akumuluar pronësor për pronarët që kanë mungesë të qasjes në pronat e tyre, dhe të aplikohen mekanizma dhe procedura efektive për ndarjen e tokës për të kthyerit.
- Të sigurohet se komunitetet në pakicë numerike në nivel komunal përfaqësohen në mekanizmat specifike komunale për mbrojtjen e komuniteteve, dhe t'u sigurohen resurse dhe udhëzime të nevojshme për t'i kryer detyrat e tyre në mënyrë më efektive.
- Të forcohen reagimet ndaj ndërtimeve të paligjshme dhe aktiviteteve në ZVM duke trajtuar boshllëqet në kornizën ligjore dhe të politikave, duke përfshirë përmes udhëzimeve të qarta për institucionet përkatëse dhe inspektorate lidhur me kompetencat e tyre për sa i përket ZVM-ve.

Për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim

- Të hartohet një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për PZH-të dhe të standardizohen proceset dhe mekanizmat për t'i ndihmuar kthimet e qëndrueshme, duke përfshirë një bazë qendrore të të dhënave.
- Të përmirësohet bashkërendimi me institucionet e nivelit qendror dhe lokal, si dhe me institucionet përkatëse rajonale, për të mbështetur zgjidhjet e qëndrueshme për PZH-të.

Për Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës

- Të trajtohen pabarazitë në qasjen në drejtësi ndërmjet komunitetit shqiptar dhe joshqiptar, mes tjerash përmes rritjes së numrit të avokatëve joshqiptarë.
- Të ngrihet vetëdijesimi i komuniteteve joshqiptare lidhur me të drejtat e tyre ligjore dhe të sigurohen ndarje adekuate të fondeve për shërbimet e ndihmës ligjore pa pagesë
- Të sigurohet se rastet penale hetohen shpejtë dhe ndiqen penalisht në mënyrë të efektshme, krimet e mundshme të nxitura nga urrejtja të gëzojnë vëmendje prioritare, dhe të sigurohet se zbatohen dhe realizohen të gjitha vendimet e mbetura pronësore të lidhura me konfliktin.

Për Policinë e Kosovës

- Të përmirësohen reagimet ndaj krimeve të nxitura nga urrejtja, të aplikohet një qasje me fokus në viktimë, si dhe të forcohet monitorimi dhe analizimi i rasteve që mund të jenë motivuar apo rënduar nga feja, raca, përkatësia etnike dhe gjuha, duke përfshirë përmes zgjerimit të bazës ekzistuese të të dhënave të PK-së.
- Të rriten përpjekjet për të rekrutuar dhe trajnuar policë nga të gjitha komunitetet, si dhe të merren veprime prioritare në fushat ku komunitetet joshqiptare apo të kthyerat janë veçanërisht të cenueshme dhe kanë përjetuar probleme të vazhdueshme të sigurisë.

Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

- Të ndërmerren hapa drejt ofrimit të një kurrikule të integruar për të gjithë studentët e Kosovës, duke përfshirë mësimin në gjuhën serbe dhe modulet që mbështesin ruajtjen e identitetit, gjuhës dhe kulturës, në konsultim me komunitetet.
- Të ofrohen mundësi për të gjitha komunitetet për t'i mësuar dy gjuhët zyrtare të Kosovës, duke përfshirë hartimin e një kurrikule për mësimin e gjuhës serbe si gjuhë joamtare, si dhe trajnime për mësimdhënës për të mësuar gjuhën shqipe si gjuhë joamtare.
- Të mbahen trajnime për mësimdhënësit e gjuhës rome dhe të sigurohet disponueshmëri e librave shkollorë në gjuhën boshnjake dhe turke, veçanërisht për arsimin e mesëm të lartë.
- Të krijohen zgjidhje apo mekanizma për të tejkaluar çështjet arsimore që prekin të drejtat e komuniteteve, duke përfshirë njohjen e diplomave dhe ndarjen e objekteve shkollore.
- Të fuqizohen veprimet që trajtojnë braktisjen e shkollimit dhe mosregjistrimin, dhe të bëhen përpjekje të veçanta për të trajtuar nevojat e nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë përmes institucionalizimit të qendrave të mësimin dhe ndërmjetësuesve.

Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- Të realizohen programe dhe politika të synuara të punësimit për burra dhe gra të komuniteteve joshqiptare, duke i kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

- Të ketë konsultime të ngushta me të gjitha komunitetet për hartimin e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.
- Të punohet me komunat për përcaktimin e mekanizmave standardë dhe transparentë për ndarje të fondeve dhe të sigurohen mundësi të barabarta për komunitetet për promovimin e kulturës dhe trashëgimisë së tyre.

Për Komisionerin e Gjuhëve

- Të ngrihet vetëdija lidhur me obligimet e institucioneve dhe të drejtat gjuhësore të komuniteteve.
- Të iniciohen dhe promovohen reforma ndërinstitutionale për trajtimin e boshllëqeve vendimtare dhe në rritje lidhur me njohuritë dhe shërbimet gjuhësore, duke përfshirë në sistemin gjyqësor.

Për Radiotelevizionin e Kosovës

- Të shtohen programet shumëgjuhëshe dhe shumëkulturore, duke përfshirë ndarjen e hapësirës së mjaftueshme transmetuese për komunitetet në pakicë numerike.

Për Kosovës

- Të përcaktohen praktika të rregullta për liderët komunalë dhe KKSBB-të, duke përfshirë përfaqësimin e plotë të komuniteteve në këshilla, kompensimin e rregullt për anëtarët, si dhe dënimet publike të incidenteve ndëretnike që arrijnë deri tek komunitetet e prekura dhe popullata shumicë.
- Nëse identifikohen apo paraqiten tensione ndërmjet komuniteteve, apo nëse të njëjtat prekin komunitetet e cënueshme siç janë të kthyerit, të realizohet kontaktim dhe komunikim më i madh me komunitetet, duke përfshirë përmes angazhimit të zyrtarëve

kyçë (siç janë NKK-të apo ZKKKK-të) për të mbështetur marrëdhëniet e përmirësuara ndërmjet komuniteteve.

- Të përmirësohet puna e Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Komiteteve për Komunitete në aktivitete të kontaktimit, vlerësimit të nevojave dhe identifikimin dhe realizimin e projekteve në të mirë të komuniteteve dhe të kthyerve.



RAPORTI I VLERËSIMIT TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE